**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**AGJENSIA E SHËRBIMEVE SOCIALE**
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE**

Nr.2827 Prot                                        Elbasan më 18 /05/2026

**RELACION**

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin PRILL 2026**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**Të nderuar Këshilltarë,**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar , ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

**Propozojmë:**

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin PRILL 2026 gjithsej 78 familje me një fond gjithsej 244.000 lekë .
   Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit .
   Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.

2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.

| | | |
|---|---|---|
| Konceptoi: | Pergj sektori | M.Duka |
| Pranoi: | Dr Pergjithshem | D.Shuli |

**Zv/kryetari**

**Asim Sula**

**Adresa:** *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr_______Prot                                                                                  Elbasan më____/05/ 2026

**PROJEKT - VENDIM**
Nr. _____ datë____/05/ 2026

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin PRILL 2026**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597,datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"
Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/05/2026

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin PRILL 2026 për 78 familje me një fond prej 244.000 lekë.
2 Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3 Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4 Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

| | | |
|---|---|---|
| Konceptoi: | Përgj sektori | M.Duka |
| Miratoi: | Dr Përgjithshëm | D.Shuli |
| | Drejtor Dr Juridike | A.Hoxha |
| | Drejtor Dr Finance | A.Merkja |
| Konfirmoi: | Zv/Kryetar | A.Sula |

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**
**Elsid Zyma**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**AGJENSIA E SHËRBIMEVE SOCIALE**
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE**

Nr.Prot 2828                                                                 Elbasan më 18 /05/2026

**RELACION**

**Mbi dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin PRILL 2026**
**KËSHILLIT BASHKIAK**

*Të nderuar Këshilltarë,*

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike", paraqesim per miratim propozimin e familjeve qe do trajtohen nga fondi i kushtezuar.

**I.** Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin **PRILL 2026**, **243 familje** me një fond prej **1.128.164 lekë.**
Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.
Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .
Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.

| | | |
|---|---|---|
| Konceptoi: | Përgj Sektori | M.Duka |
| Pranoi: | Dr Përgjithshëm | D.Shuli |

**ZV/ KRYETARI**

**Asim Sula**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN**

Nr_______Prot Elbasan më____/05/ 2026

**PROJEKT – VENDIM**

Nr. ____ datë ____/05/2026

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin PRILL 2026**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike" Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/05/2026 pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Sherbimit Social

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **PRILL 2026** për **243** familje me një fond prej **1.128.164** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

| | | |
|---|---|---|
| Konceptoi: | Përgj sektori | M.Duka |
| Pranoi : | Dr Përgjithshëm | D.Shuli |
| | Drejtor Dr Juridike | A.Hoxha |
| | Drejtor Dr Finance | A.Merkja |
| Konfirmoi: | Zv/Kryetar | A.Sula |

**Sekretar i Këshillit Bashkiak** **Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Elsid Zyma** **Lutfi Lala**

**BASHKIA ELBASAN**
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL**
**SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE AFTËSISË SË KUFIZUAR**

## INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN PRILL 2026

### I. Ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Prill 2026

| | | | |
|---|---|---|---|
| Prill | 243 familje | fondi | 1.128.164 |
| Mars | 249 familje | fondi | 1.163.187 |

Për muajin Prill 2026 kemi 6 familje më pak se muaji paraardhes që propozojme te trajtohen me ndihmè ekonomike nga fondi I kushtèzuar.

Fondi është 35.023 lekë më pak se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar janë:

1. Eriglina Çekani (riaplikon ne sistem)
2. Artur Sula (riaplikon ne sistem)
3. Hedie Idrizi (riaplikon ne sistem)
4. Kule Drako (riaplikon në sistem)
5. Manjola Havaja (riaplikon në sistem)
6. Marsela Muça (riaplikon në sistem)
7. Matilda Çaushi (riaplikon ne sistem)
8. Natasha Salla (riaplikon ne sistem)
9. Ruzhdije Shguni (riaplikon ne sistem)
10. Vasip Hoxha (riaplikon ne sistem)
11. Kujtim Zdrava (riaplikon ne sistem)
12. Xhuljeta Myftaraj (riaplikon ne sistem)
13. Xhevahir Korra (riaplikon ne sistem)
14. Skènder Nuredini (riaplikon ne sistem)
15. Fatmira Panxhi (riaplikon ne sistem)
16. Imelta Caushi (riaplikon ne sistem)
17. Lavdije Xhaja (del me P.A.K)
18. Dritan Salla (riaplikon ne sistem)
19. Klaudia Luta (riaplikon ne sistem)

## II. Ndihma ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Prill 2026

| | | | |
|---|---|---|---|
| Prill | 78 familje | fondi | 244.000 |
| Mars | 77 familje | fondi | 240.000 |

Për muajin Prill 2026 kemi 1 familje më shume se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi i shpenzuar është 4.000 lekë më shume se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I Bashkisë janë :

1. Elda Fejza (nuk terheq leket)
2. Elida Hida (nuk terheq leket)
3. Gezim Lolja (perfitues ne sistem)
4. Shpètim Elezi (riaplikon ne sistem)
5. Rrapush Hanoli (riaplikon ne sistem)
6. Suela Çakri (nuk paraqitet)
7. Shpresa Tola (nuk paraqitet)
8. Juliana Bejkolli (riaplikon ne sistem)
9. Dylaver Llozi (riaplikon ne sistem)
10. Faik Meta (riaplikon ne sistem)
11. Rrahmije Musta (riaplikon ne sistem)
12. Ruzhdi Kuka (riaplikon ne sistem)
13. Hamit Shako (riaplikon ne system)
14. Altin Guraziu (riaplikon ne sistem)

**Konceptoi**

**Specialiste Ermira Dika**

**Pèrgjegjèse Sektori**

**Miranda Duka**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TË ZHVILLIMIT EKONOMIK, KULTURËS DHE TURIZMIT**
**DREJTORIA E POLITIKAVE TË TURIZMIT DHE TRASHËGIMISË KULTURORE**
**SEKTORI I TRASHËGIMISË KULTURORE**

Nr. 2828 Prot. Elbasan 18.05.2026

# RELACION

**Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi"**
**z. Qazim Sejdinit (pas vdekjes)**

*Të nderuar këshilltarë!*

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 94/2022 "Për dekoratat dhe titujt vendorë të nderit", si dhe rregullores përkatëse të Këshillit Bashkiak Elbasan, paraqitet për shqyrtim propozimi i Kryetarit të Bashkisë Elbasan z. Gledian Llatja, për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) për figurën e Z. Qazim Sejdini. Një personalitet që la gjurmë të thella në historinë moderne të qytetit tonë dhe që do mbetet në kujtesën e qytetarëve tanë si një prej figurave më të spikatura të qeverisjes vendore dhe jetës publike shqiptare, për kontributin e jashtëzakonshëm në zhvillimin, transformimin dhe promovimin e qytetit të Elbasanit, si dhe për përkushtimin e palëkundur në shërbim të qytetarëve

Qazim Sejdini lindi në Elbasan më 12 shkurt 1951, në një familje me tradita të hershme qytetare elbasanase, ku dashuria për punën, ndershmëria dhe respekti për njerëzit ishin vlera të trashëguara brez pas brezi. Që në fëmijëri, ai u rrit me ndjenjën e krenarisë për qytetin e tij dhe me bindjen se Elbasani meritonte të zhvillohej, të ruante identitetin e tij dhe të ecte përpara me dinjitet. Formimi i tij intelektual, përvoja si mësues, drejtues sportiv, sipërmarrës, drejtues i institucioneve dhe administrator publik, krijuan profilin e një lideri të afërt me njerëzit, vizionar dhe të përkushtuar ndaj zhvillimit të komunitetit.

Jeta e tij profesionale nisi si mësues në zonën e Labinotit, ku u dallua menjëherë për përkushtimin ndaj të rinjve dhe aftësinë për të komunikuar me njerëzit. Më pas, në detyra organizative rinore

dhe sportive, ai dëshmoi energji, disiplinë dhe vizion. Kontributi i tij në sportin elbasanas si drejtues mbetet i rëndësishëm, ai ndihmoi në ringritjen e Klubit Sportiv të Elbasanit dhe rikthimin e identitetit historik të tij në një periudhë të vështirë për vendin.

Në vitet e tranzicionit demokratik, Qazim Sejdini ishte ndër sipërmarrësit e parë të qytetit, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe në krijimin e një fryme të re biznesi në Elbasan. Si drejtues i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë dhe më pas President i Unionit të Dhomave të Tregtisë së Shqipërisë, ai punoi për të forcuar ekonominë vendore dhe për të promovuar Elbasanin si një qytet me potencial zhvillimi dhe bashkëpunimi.

Që prej vitit 2002, si Prefekt i Qarkut Elbasan, përfaqësuesi më i lartë i qeverisë qendrore në një nga qarqet më të populluara të Shqipërisë, ai solli pragmatizmin dhe kujdesin që e karakterizonte për mirëqenien e komunitetit. Gjatë ushtrimit të kësaj detyre, ai u përqendrua në zgjidhjen e problemeve konkrete të qytetarëve dhe në forcimin e rolit të institucioneve publike. Një nga sfidat më të rëndësishme ishte ndotja mjedisore e zonave industriale të Elbasanit, për të cilën ai ndërmori masa konkrete duke detyruar kompanitë industriale të instalonin filtra ajri dhe duke vendosur monitorim periodik për respektimin e standardeve mjedisore. Gjithashtu në këtë detyrë, ai përforcoi sistemin e emergjencave civile dhe koordinimin institucional gjatë përmbytjeve sezonale, duke rritur efektivitetin e reagimit ndaj krizave. Përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe hapjes së institucionit të Prefekturës ndaj komunitetit, Z. Sejdini riktheu besimin e publikut tek administrata vendore dhe e ktheu figurën e prefektit në një institucion të afërt dhe funksional për qytetarët.

Por kontributi më i madh dhe më i dukshëm i tij lidhet pa dyshim me drejtimin e Bashkisë së Elbasanit për tre mandate radhazi, në vitet 2007–2019. Gjatë drejtimit të Bashkisë Elbasan Z. Qazim Sejdini udhëhoqi një prej proceseve më të rëndësishme transformuese në historinë moderne të qytetit, duke e kthyer Elbasanin në një qendër me interes të shtuar turistik dhe historik. Nën drejtimin e tij, Elbasani njohu zhvillime të dukshme në infrastrukturë, urbanistikë, kulturë, arsim, sport dhe turizëm, duke fituar një identitet të ri qytetar dhe duke e shndërruar në një qytet më modern, funksional dhe mikpritës. Gjatë këtyrë viteve të transformimit të rendësishëm për qytetin tone, Elbasani nën drejtimin e tij ndryshoi pamje. Krahas investimeve në infrastrukturë, në rikualifikimin urban, në ndriçim, në rrugë, ura, shkolla, kopshte dhe hapësira publike, u restauruan dhe u promovuan vlerat historike e kulturore të qytetit, duke nxjerrë në pah trashëgiminë tonë të çmuar dhe duke e kthyer Elbasanin në një destinacion gjithnjë e më të njohur për vizitorët vendas dhe të huaj. Nën drejtimin e tij u realizuan projekte që sot konsiderohen pjesë e identitetit modern të qytetit: restaurimi dhe ndriçimi i mureve të kalasë, rikonstruksioni i zonave historike dhe vecanërisht zbulimi dhe evidentimi i mozaikut paleokristian të kishës së Shën Pietrit pranë Rrapit të Bezistanit, ndërtimi i stadiumit "Elbasan Arena", zhvillimi i jetës kulturore e sportive dhe promovimi i Ditës së Verës si simbol i identitetit elbasanas në rang kombëtar e ndërkombëtar.

Në vitin 2009, nën drejtimin e tij qyteti i Elbasanit u nderua me çmimin **"Destination to be Discovered"** në Lugano, Zvicër, një vlerësim ndërkombëtar që evidentoi potencialin historik, kulturor dhe turistik të qytetit. Ky çmim shënoi një moment të rëndësishëm për promovimin ndërkombëtar të Elbasanit dhe përfshirjen e tij për herë të parë në Hartën Turistike Botërore. Vlerësimi nxori në pah trashëgiminë 2000-vjeçare të qytetit, ndërthurjen e qytetërimeve romake, bizantine dhe osmane, si dhe identitetin e tij si një qytet i dijes, kulturës dhe bashkëjetesës.

Kontributi i tij në restaurimin dhe promovimin e trashëgimisë historike e kulturore të qytetit, në rilindjen urbane të Elbasanit, në ndërtimin e veprave publike me rëndësi strategjike si dhe në fuqizimin e jetës kulturore, sportive dhe ekonomike, mbetet një trashëgimi e vyer për ne dhe për brezat që do të vijnë.

Z. Qazim Sejdini besonte se qyteti nuk ndërtohet vetëm me projekte infrastrukturore, por mbi të gjitha me harmoni, respekt dhe bashkëjetesë. Ai ishte një mbështetës i palodhur i tolerancës fetare dhe i bashkëpunimit qytetar. Ai kontribuoi në ruajtjen e frymës së mirëkuptimit që e ka karakterizuar gjithmonë Elbasanin dhe mbështeti nisma me rëndësi të madhe kulturore e shpirtërore për komunitetin. Me vizionin, integritetin dhe frymën bashkëpunuese që e karakterizonte, ai promovoi modelin e një qeverisjeje të bazuar mbi dialogun, përfshirjen qytetare, mirëkuptimin politik dhe respektin për çdo komunitet. Përkushtimi i tij ndaj ruajtjes e harmonisë fetare dhe vlerave qytetare e bëri një simbol të unitetit dhe bashkëjetesës në Elbasan.

Ndër kontributet e tij më të spikatura në ruajtjen e harmonisë dhe trashëgimisë fetare të qytetit ka qenë mbështetja e tij vendimtare për rindërtimin e Xhamisë së Ballies në vitin 2013. Xhamia, e ndërtuar fillimisht në vitin 1608 dhe e shkatërruar nga regjimi komunist në vitin 1967, përfaqësonte një simbol të rëndësishëm historik dhe shpirtëror për qytetin e Elbasanit. Z. Sejdini bashkëpunoi ngushtë me Komunitetin Mysliman dhe kontribuoi në sigurimin e mbështetjes ndërkombëtare për financimin e projektit të rindërtimit. Falë kësaj nisme, Xhamia e Ballies u rikthye si një nga objektet më përfaqësuese të arkitekturës moderne fetare në Shqipëri dhe u vlerësua ndër pesë objektet e kultit më të bukura në botë në finalen e çmimit prestigjioz "Ndërtesa e Vitit 2025" nga ArchDaily.

Në shenjë vlerësimi për kontributin e tij në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, Z. Qazim Sejdini u nderua në vitin 2013 në Shtetet e Bashkuara me "Çelësin e Qytetit" të Idahos dhe me titullin "Qytetar Nderi" të qytetit Pensacola në Florida.

Një nga cilësitë që qytetarët kujtojnë më shumë tek ai ishte afërsia me njerëzit. Dyert e institucionit ishin të hapura për qytetarët e thjeshtë, për hallet dhe shqetësimet e tyre. Ai e kuptonte pushtetin si përgjegjësi dhe shërbim, jo si privilegj. Kjo është arsyeja pse ai fitoi respektin dhe besimin e qytetarëve për tre mandate radhazi, me një besim gjithnjë në rritje.

Për qytetarët e Elbasanit, Qazim Sejdini mbetet figura e një drejtuesi që e deshi qytetin me zemër, punoi me devotshmëri për të dhe ia kushtoi jetën përparimit të tij. Vepra dhe trashëgimia e tij përbëjnë sot një model frymëzimi për shërbimin publik me dinjitet, ndershmëri dhe përkushtim.

**Konceptoi:** Sp. DPTTK E. Ibërshimi
**Miratoi:** Dr. DPTTK A.Guni
**Konfirmoi:** Dr. DPZHEKT A.Canaj

**KRYETARI**
**Gledian LLATJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. ____ Prot.** **Elbasan___.___.2026**

**PROJEKT - VENDIM**

**Nr._____datë:___.___.2026**

**Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi"**
**z. Qazim Sejdinit (pas vdekjes)**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Turizmit dhe Trashëgmisë Kulturore (Sektori i Trashëgimisë Kulturore), *"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" z. Qazim Sejdinit"*, mbështetur në nenin 54 të ligjit nr.139/2015 "Për vetë qeverisjen vendore"(i ndryshuar), si dhe në nenin 9 të ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë".

**VENDOSI:**

1. Ti japë titullin "Qytetar Nderi" i Elbasanit, **z.Qazim Sejdinit** me motivacionin: " Për kontributin e jashtëzakonshëm në zhvillim , transformimin dhe promovimin e qytetit të Elbasanit si dhe për përkushtimin e palëkundur në shërbim të qytetarve dhe interesit publik"

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**
**Elsid ZYMA**

**KRYETARI**
**Lutfi LALA**

*Konceptoi:*
*Specialist* *E. Ibërshimi*
*Drejtori DPTTK* *A.Guni*
*Drejtori DPZHEKT* *A.Canaj*
*Drejtoria Juridike:* *A. Hoxha*

**Adresa:** *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152,e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.alweb:www.elbasani.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

# KARTELA SHOQËRUESE PRAKTIKE

Dërgues A. J. D. S. Shtetit Nr. Prot. 814/3 Datë __/__/__

Shkurtimi i lëndës Kthim përgjigje

| | |
|---|---|
| Për trajtim nga | A. Guni |
| (Struktura të tjera të ngarkuara) | |
| Me porosi | |

Afati ☐ Normal (7 ditë) ☐ Prioritet (3 ditë) ☐ Urgjent (brenda ditës) ☐ Pa afat/Për dijeni/Tjetër

Data 7/5/26 Nr. Prot. 1968/1 Nënshkrimi (________)

Marrë në dorëzim ________ Nënshkrimi (________)

Kalim për trajtim (struktura) ________

Me porosinë ________ __/__/__

Marrë në dorëzim ________ Nënshkrimi (________)

Kalim për trajtim Specialisti ________

Me porosinë ________ __/__/__

Trajtim i materialit përfunduar më __/__/__ Specialisti ________

Trajtim i materialit përfunduar më __/__/__ Përgjegjës sektori ________

Trajtim i materialit përfunduar më __/__/__ Sekretari i përgjithshëm ________

1868/
7.5.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

DREJTORIA E VERIFIKIMIT TË FIGURAVE

Nr. 814/3 Prot. Tiranë, më 04.05.2026

**Lënda:** Informim mbi rezultatin e verifikimit të pastërtisë për kandidatin e propozuar për dhënien e titullit të nderit.

**KRYETARIT TË BASHKISË ELBASAN**

**Z. Gledian Llatja**

I nderuar z. Llatja!

Në përgjigje të shkresës nr. nr. 1968, prot., datë 08.04.2026 (tonën nr. 814 prot., datë 10.04.2026) "Kërkesë për informacion", të Institucionit të Bashkisë Elbasan drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), për verifikimin e figurës për z. Qazim Sejdini, në kuadër të dhënies së titullit të nderit, bashkëlidhur do të gjeni:

Vendimin nr. 327, datë 30.04.2026 të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Sofi Noti**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga Kongresi i Manastirit, Garnizoni "Skënderbej", Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al
email:info@autoritetidosjeve.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 956/10 Prot. Tiranë, më 30.04.2026

**VENDIM**

**Nr. 27 Datë 30.04.2026**

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 30.04.2026, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

| | |
|---|---|
| Znj. Gentiana Sula | Kryetare |
| Z. Altin Hoxha | Anëtar |
| Z. Albert Nikolla | Anëtar |
| Z. Gjergj Marku | Anëtar |
| Z. Skënder Vrioni | Anëtar |

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Kërkesa e paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Elbasan, me shkresën nr. 1968, prot., datë 08.04.2026, "Kërkesë për informacion", për verifikimin e figurës së z. Qazim Sejdini, kandidat i propozuar për titull nderi.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 45/2015 "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*".

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Elbasan, me shkresën nr. 1968, prot., datë 08.04.2026, sipas objektit të saj,

**VËREN:**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to.

Në nenin 10, pika "dh" të Ligjit nr. 45/2015, një nga detyrat e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është edhe informimi i individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, sipas këtij ligji.

Nga përmbajtja e shkresës nr. 1968, prot., datë 08.04.2026, "Kërkesë për informacion", Institucioni i Bashkisë Elbasan, në zbatim të detyrimeve ligjore që rjedhin nga Ligji nr. 45/2015 "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*", i ka kërkuar Autoritetit nëse disponon informacion, lidhur me z. Qazim Sejdini, kandidat i propozuar për titull nderi, me përmbajtje sipas shkresës së dërguar nga Bashkia Elbasan.

Mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera deri tani referuar të dhënave të paraqitura nga institucioni kërkues, për z. Qazim Sejdini, nuk

figuron të ketë materiale në emër të tij, sipas Nenit 30, të Ligjit Nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" i ndryshuar.

**PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 *"Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"*, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 *"Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike"*, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

**V E N D O S I**

1.Të informojë Institucionin e Bashkisë Elbasan, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 1968, prot., datë 08.04.2026, "Kërkesë për informacion", në kuadër të propozimit për titull nderi, se nga verifikimet e kryera deri tani, sipas përcaktimeve të nenit 30 të Ligjit nr. 45/2015 *"Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"*, rezulton se z. Qazim Sejdini;

a) Nuk ka qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese posaçme politike, apo punonjës i nivelit të lartë i ish-Sigurimit të Shtetit;
b) Nuk ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, denoncues në proceset politike ose dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme, pas mbushjes së moshës 18 vjeç;
c) Nuk ka qenë person me të dhëna nga ish-Sigurimi i Shtetit për spiunazh dhe terrorizëm.

2. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet institucionit të Bashkisë Elbasan.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

**KRYETARJA**

**Dr. Gentiana Sula**

| ANËTAR | ANËTAR | ANËTAR | ANËTAR |
|---|---|---|---|
| **Dr. Albert Nikolla** | **Altin Hoxha** | **Gjergj Marku** | **Skënder Vrioni** |

# CURRICULUM VITAE

| | |
|---|---|
| ***Emri Mbiemri*** | Qazim Sejdini |
| ***Datelindja*** | 12.02.1951 |
| ***Vendlindja*** | Elbasan |
| ***Adresa*** | L "Brigada 17 Sulmuese", Rr. "Ali Jolldashi", Nr 7, Elbasan |
| ***Mob*:** | +355 68 20 34 095 |

**PUNESIMI**

| | |
|---|---|
| 2007 – 2019 | Kryetar i Bashkisë Ebasan për 3 mandate |
| 16 Tetor 2002-Maj 2005 | Prefekt i Qarkut Elbasan. |
| Maj 2002-Maj 2004 | Kryetar i Bashkimit te Dhomave te Tregtise dhe Industrise se Shqiperise. |
| 1996-2004 | Kryetar i Shoqates se Agjentit Doganor Shqiptar. |
| 1995-2004 | Kryetar i Dhomes se Tregtise dhe Industrise, Elbasan. |
| 1992- 2002 | Administrator i pergjithshem i Shoqerise Tregtare "Miqesia" sh.p.k. |
| 1989-1992 | Shef i Klubit Sportiv Elbasani. |
| 1983-1989 | Inspektor i lojrave me dore ne Sport Klub Labinoti. |
| 1974-1983 | Instruktor i Komitetit te Rinise, Elbasan |
| 1973-1974 | Mesues ne shkollen 8-vjeçare Labinot Mal, Histori Gjeografi dhe Fiskulture. |
| 1970-1973 | Sherbimi Ushtarak |

**EDUKIMI**

| | |
|---|---|
| 1983-1987 | Studime ne Institutin e Larte te Kultures Fizike "Vojo Kushi", Tirane. |
| 1973-1978 | Studime ne UE "A. Xhuvani", dega Histori-Gjeografi. |
| 1968-1970 | Studime ne Fakultetin "L.Gurakuqi", dega Histori-Gjeografi-Fiskulture, Shkoder. |
| 1964 -1968 | Studime ne shkollen e mesme te pergjithshme |

"Jeronim De Rada" Elbasan.

**EDUKIM I METEJSHEM**

Pjesemarres ne kurse te ndryshme trajnimi si ne Vjene, Milano, Bari, Tirane, Elbasan, me tematika ne fushen e menaxhimit dhe administrimit publik (te çertifikuara).

**KONTRIBUTE TE TJERA**

Botime ne publikime zyrtare te MPVD mbi Funksionet dhe Misionin e Prefektit.

**AKTIVITETI POLITIK**

Anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste të Shqiperisë
Kryetar i Deges se PS Elbasan
Anetar i Kryesise se PS, Dega Elbasan.
Anetar i Asamblese te Partise Socialiste te Shqiperise.
Kandidat per Deputet i PS ne zonen nr.54 Elbasan.

**GJUHE TE HUAJA**

Njohje e mire e gjuhes ruse.
Njohje e gjuhes Italiane

**COMPUTER**

Njohuri te programeve WORD, EXCEL, Windows,etj.

**VLERESIME**

"Qytetar Nderi" i Eagle City, Idaho, SHBA

"Lead Mayor 2010", vlerësuar nga "World Mayors Forum Mayors" Londër, Angli

"Kryetari Bashkisë më i mirë" nga Organizatat e Shoqërise Civile në Elbasan.

"Kryetari më mbështetës" vlerësime të mara nga organizata dhe federata sportive kombëtare si: atletikës, karatesë, çiklizmit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PERGJITHSHME E KULTURES DHE SPORTIT

KLUBI SHUMESPORTESH ELBASAN

Nr.prot 119

Elbasan më 14/ 4 / 2026

Lënda: VËRTETIM

Klubi Shumësportesh Elbasani vërteton se:

Z. **Qazim Sejdini** ka ushtruar detyrën e **Shefit të Klubit** pranë Klubit Shumësportesh Elbasani gjatë periudhës **1989 – 1992.**

Ky vërtetim lëshohet për qëllime zyrtare.

**DREJTOR**
**ARTIN KOVAÇI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
E PERGJITHSHME E KULTURES DHE SPORTIT
DREJTORIA
BASHKIA E

**Greetings:** BE IT HEREBY KNOWN TO ALL THAT

**MR. QAZIM SEJDINI**

HAS ON THIS __1ST__ DAY OF __February__ 20 13

BEEN APPOINTED AN

# Honorary Citizen

OF THE

## City of Pensacola

AND IN RECOGNITION THEREOF HAS BEEN PRESENTED WITH THIS

## CERTIFICATE OF CITIZENSHIP

Mayor,
*City of Pensacola, Florida*

# Official Key to the City
# Eagle, Idaho

Presented to:

**Mayor Qazim Sejdini**

**Elbasan City**

Presented this 11th day of February, 2013.

James D. Reynolds, Mayor

**Nderi i Atletikes Shqiptare**

**I Jepet**

**z. Qazim Sejdini**

*Për punën e shkëlqyer shumëvjecare,*
*kontribut të shquar në rritjen e cilësisë sportive,*
*dhe drejtues i sportit ndër vite.*

**Gjergj Ruli**
**President i FShA-së**

**Nikolin Dionisi**
**Sekretar i Përgjithshëm i FShA-së**

TIRANË


Athletic Federation of Macedonia
alocates GRATITUDE
to
M-r Qazim Sejdini
Mayor of Elbasan
for unselfish help in the development
of the Athletic sport in the Balkans
President of AFM
Krsto Serafimovski

INSTITUTI I LIBRIT
DHE I PROMOCIONIT

# *Diplomë Mirënjohjeje*

I jepet:

## z. QAZIM SEJDINI

**KRYETAR I BASHKISË SË ELBASANIT**

*Për mikpritjen tradicionale, shprehjet më miqësore të bashkëpunimit dhe mbështetje të gjithanshme për veprimtaritë kulturore dhe turistike e në mënyrë të veçantë të kolonisë së piktorëve të Elbasanit.*

Për bordin drejtues
**Patos Kongoli**

Drejtore e përgjithshme
**Irena Toçi**

Tiranë, më [illegible]



Federata Shqiptare e Çiklizmit

# MIRËNJOHJE

*i jepet* Z. **Qazim Sejdini**

***Per partneritetin, mbeshtetjen e jashtezakonshme ndaj sportit te ciklizmit ne vendin tone. Fale ndihmeses tuaj kemi mundur qe te zhvillojme me sukses aktivitetin nderkombetar "75 Tour of Albania" ne date 19-23 Maj 2018***

*19 Maj 2018, Tiranë*

**Presidenti i FSHÇ**
**Skender ANXHAKU**

Federata Shqiptare e Çiklizmit

# MIRËNJOHJE

*i jepet* **Z. Qazim Sejdini**

***Per partneritetin, mbeshtetjen e jashtezakonshme ndaj sportit te ciklizmit ne vendin tone. Fale ndihmeses tuaj kemi mundur qe te zhvillojme me sukses aktivitetin nderkombetar "75 Tour of Albania" ne date 19-23 Maj 2018***

**Presidenti i FSHÇ**
**Skender ANXHAKU**

19 Maj 2018, Tiranë

**VENDIM**
**Nr.349, datë 20.5.2005**

**PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 "Për prefektin", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Qazim Sejdini, prefekt i qarkut Elbasan, të lirohet nga kjo detyrë, sipas kërkesës së vet, si rrjedhojë e kandidimit për deputet në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005.
2. Z. Agim Leka të emërohet prefekt i qarkut Elbasan.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

**Nr.533 Prot.** **Elbasan, më 26.5.2026**

# VËRTETIM

Me anën e të cilit vërtetojmë se **Z. Qazim Ali Sejdini,** ka qenë i punësuar prej datës 16.10.2002 deri më datë 29.05.2005 pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan në pozicionin Prefekt.

E lëshojmë këtë vërtetim sipas kërkesës të të interesuarve.

**PREFEKTI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**Ilir BEJTJA**

Adresa: Lagjia "Brig.17 Sulmuese", Rruga "Q.Stafa", Tel: 054 252138, www.prefektielbasan.gov.al, prefekti.elbasan@mb.gov.al

KOMUNA E TETOVËS
ОПШТИНА ТЕТОВО
MUNICIPALITY OF TETOVA

Me rastin e 3 marsit (dita e Komunës së Tetovës) i ndanë këtë:

# MIRËNJOHJE

z. Qazim Sejdini

**KRYETAR I BASHKISË SË ELBASANIT**

*Për kontributin e dhënë në të mirë të paqes dhe kulturës së një kombi, të një gjuhe , në dy shtete*

Komuna e Tetovës,
03. 03. 2011

Kryetari i Komunës së Tetovës,

*Prof. dr. Sadi Bexheti*

# MIRENJOHJE

Organizata Bamirese "Al-Najat" me qender ne Kuvajt, ka nderin te dorezoje kete mirenjohje per:

## Z. Qazim Seidini

Kryetar i Bashkise se Elbasanit

Per kontributin e dhene ne nxitjen e tolerances nderfetare dhe per ndihmen e madhe qe i keni dhene Organizatave Bamirese Kuvajtiane qe veprojne ne Republiken e Shqiperise.

# MIRENJOHJE

Organizata Bamirese "Al-Najat" me qender ne Kuvajt, ka nderin te dorezoje kete mirenjohje per:

# Z. Qazim Seidini

Kryetar i Bashkise se Elbasanit

Per kontributin e dhene ne nxitjen e tolerances nderfetare dhe per ndihmen e madhe qe i keni dhene Organizatave Bamirese Kuvajtiane qe veprojne ne Republiken e Shqiperise.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
QEMAL BAHOLLI
Elbasan

---

Elbasan, më 26 shtator 2014

CERTIFIKATË MIRËNJOHJEJE

Z. Qazim SEJDINI

Me vlerësime të larta
për mbështetjen e vijueshme dhënë
Bibliotekës Publike "Qemal Baholli"
për grumbullimin dhe krijimin e
kujtesës lokale dixhitale
të qytetit me tradita kulturore të Elbasanit

Drejtor

Drita CANKJA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT EKONOMIK, KULTURËS DHE TURIZMIT**
**DREJTORIA E POLITIKAVE TË TURIZMIT DHE TRASHËGIMISË KULTURORE**
**SEKTORI I TRASHËGIMISË KULTURORE**

**Nr.____ Prot**

**Elbasan 06 .05. 2026**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit Këshillimor për shqyrtimin e propozimeve për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes)**

Sot, më datë 06 / 05 / 2026, ora 13:30 në ambientet e Bashkisë Elbasan, u zhvillua mbledhja e Komisionit Këshillimor për shqyrtimin e propozimeve për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes), për figurat:

1. Dr. Av. Fejzullah Sejdini, propozuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë;
2. Prof. As. Dr. Kujtim Bevapi, propozuar nga Universiteti "Aleksandër Xhuvani";
3. z. Qazim Sejdini, propozuar nga Kryetari i Bashkisë, z. Gledian Llatja.

**Të pranishëm:**

| **Emër Mbiemër** | **Funksioni** | **Nënshkrimi** |
|---|---|---|
| Hektor Çiftja | Anëtar | [signature] |
| Teuta Toska | Anëtar | [signature] |
| Ergys Muzhaqi | Anëtar | |

| | | |
|---|---|---|
| Fatmir Musai | Anëtar | |
| Rudina Mita | Anëtar | [signature] |
| Hyqmet Zane | Anëtar | [signature] |
| Mustafa Kadzadej | Anëtar | [signature] |

**Munguan:**

Engjys Muzhaqi, Fatmir Musai (probleme shëndetësore)

Mbledhja u hap nga Kryetari i Bashkisë, i cili prezantoi rendin e ditës dhe dokumentacionin e paraqitur nga institucionet propozuese.

Pas shqyrtimit të dosjeve, diskutimeve dhe vlerësimit të kontributit profesional, qytetar dhe institucional të figurave të propozuara, Komisioni Këshillimor **vendosi** si më poshtë:

**1. Për figurën e Dr. Av. Fejzullah Sejdini**

Rezultati i votimit:

- Pro: 5
- Kundër: –
- Abstenim: –

Vendimi:
☒ Miratohet kalimi për shqyrtim në Këshillin Bashkiak
☐ Nuk miratohet

"Personalitet i shquar i rezistencës dhe model i kalimit të profesionit të juristit në sistemin para dhe pas Luftës së Dytë Botërore, duke respektuar parimet e ligjshmërisë. Molivimi nga Hektor Ciftja

**2. Për figurën e Prof. As. Dr. Kujtim Bevapi**

Rezultati i votimit:

- Pro: 5
- Kundër: –
- Abstenim: –

Vendimi:
☐ Miratohet kalimi për shqyrtim në Këshillin Bashkiak
☐ Nuk miratohet

Të gjithë dakord njëzëri për aprovim.

**Për figurën e z. Qazim Sejdinit**

Rezultati i votimit:

- Pro: 5

- Kundër: –

- Abstenim: –

Vendimi:
☑ Miratohet kalimi për shqyrtim në Këshillin Bashkiak
☐ Nuk miratohet

______________________________________________
______________________________________________
______________________________________________
______________________________________________.

Në përfundim, Komisioni Këshillimor rekomandon vijimin e procedurave sipas legjislacionit në fuqi për trajtimin e propozimeve nga Këshilli Bashkiak.

Mbledhja u mbyll në orën 14:15.

**KOMISIONI KËSHILLIMOR**

| Emër Mbiemër | Funksioni | Nënshkrimi |
|---|---|---|
| Hektor Çiftja | Anëtar | Hektor Çiftja [signature] |
| Teuta Toska | Anëtar | [signature] |
| Ergys Muzhaqi | Anëtar | |
| Fatmir Musai | Anëtar | |
| Rudina Mita | Anëtar | [signature] |
| Hyqmet Zane | Anëtar | [signature] |
| Mustafa Kadzadej | Anëtar | [signature] |

Mbajti procesverbalin:

Funksioni: Përgjegjëse e sektorit të turizmit (DPTTK) Nënshkrimi: Silva BELEGU
Silva Belegu

10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT EKONOMIK, KULTURËS DHE TURIZMIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË TURIZMIT DHE TRASHËGIMISË KULTURORE
SEKTORI I TRASHËGIMISË KULTURORE

**Nr. 1968 Prot** **Elbasan 08.04.2026**

**Lënda: Kërkesë për informacion.**

**AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH SIGURIMIT TË SHTETIT**
**Rruga Kongresi i Manastirit, Tiranë.**

Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 94/2022, "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr.45/2015 (i ndryshuar) "Për Të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" kërkojmë nga ana juaj dërgimin e informacion për verifikimin e pastërtisë së figurë së shtetasit Qazim Sejdini, i cili është propozuar për titullin Qytetar Nderi.

Qazim Sejdini, lindur më 12.02.1951 në Elbasan, është një personalitet me kontribut të gjatë në administratën publike dhe jetën institucionale në vend. Ai ka ushtruar funksione të rëndësishme drejtuese, ndër të cilat spikat detyra e Kryetarit të Bashkisë Elbasan për tre mandate (2007–2019), si dhe Prefekt i Qarkut Elbasan (2002–2005).

Gjatë karrierës së tij, ka mbajtur pozicione drejtuese në organizata të rëndësishme ekonomike dhe profesionale, si Kryetar i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë (2002–2004), Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Elbasan (1995–2004) dhe Kryetar i Shoqatës së Agjentëve Doganorë Shqiptarë (1996–2004).

Përvoja e tij përfshin edhe drejtimin në sektorin privat si Administrator i Përgjithshëm i shoqërisë "Miqësia" sh.p.k. (1992–2002), si dhe angazhime në sport, edukim dhe rini.

Gjithashtu ka ushtruar profesionin e mësuesit në shkollën 8-vjeçare "Labinot Mal" gjatë vitit 1973-74.

Faleminderit për bashkëpunimin!

Konceptoi: Silva Belegu

Pranoi:Artur Guni

Miratoi: Alba Canaj

**KRYETAR I BASHKISË**
**Gledian LLATJA**

**ME URDHËR DHE ME POROSI**
**ZV\KRYETAR**
**Klaudia KRASNIKA**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**DREJTORIA E POLITIKAVE TË BUJQËSISË, PYJEVE, MJEDISIT, STATISTIKAVE DHE PERFORMANCËS**
**SEKTORI I STATISTIKAVE DHE PERFORMANCËS**

Nr. 2826 prot. Elbasan, më 18.05.2026

# Relacion

***"MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET BASHKISË ELBASAN DHE INCA NË KUADËR TË PROJEKTIT "BeMed+"***

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr.10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", ligjit nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", si dhe në kuadër të politikave vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme, paraqitet për miratim Marrëveshja e Mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe organizatës INCA, në kuadër të projektit "BeMed+".

**Projekti BeMed+** mbështetet financiarisht nga **FFEM** dhe synon reduktimin e ndotjes nga plastika njëpërdorimëshe në rajonin e Mesdheut, përmes masave konkrete për ndërgjegjësim, edukim mjedisor, menaxhim më të mirë të mbetjeve plastike dhe promovim të praktikave të qëndrueshme.

Në kuadër të këtij projekti, **organizata INCA** është organizata koordinuese dhe implementuese lokale e autorizuar për Shqipërinë, ndërsa **Bashkia Elbasan** propozohet të jetë partner institucional në zbatimin e aktiviteteve që lidhen me mbrojtjen e Lumit Shkumbin dhe reduktimin e ndotjes plastike në territorin e Bashkisë Elbasan.

Marrëveshja synon:

- reduktimin e përdorimit të plastikës njëpërdorimëshe;
- përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve plastike;
- rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe edukimit mjedisor;
- promovimin e praktikave të ripërdorimit dhe ekonomisë qarkulluese;
- forcimin e bashkëpunimit institucional dhe komunitar.

Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes parashikohen aktivitete si:

- fushata pastrimi dhe ndërgjegjësimi;

- vendosja e infrastrukturës mbështetëse për reduktimin e mbetjeve plastike;
- aktivitete edukative me shkolla dhe komunitetin;
- mbështetje teknike dhe logjistike;
- aktivitete monitorimi dhe raportimi mbi ndotjen plastike.

**Marrëveshja nuk krijon detyrime financiare** apo **bashkëfinancim** të detyrueshëm për Bashkinë Elbasan. Mbështetja financiare, materiale dhe teknike realizohet nga INCA dhe/ose partnerët e projektit BeMed+, sipas fondeve të disponueshme dhe planit të aktiviteteve të projektit.

Për koordinimin teknik dhe institucional të zbatimit të kësaj marrëveshjeje është përcaktuar Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Statistikave dhe Performancës, e përfaqësuar nga drejtoresha znj. Lorena Haxhiymeri.

Sa më sipër, propozohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe INCA, si dhe autorizimi i Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e saj.

***Konceptoi:*** *DPBPMSP* *L.Haxhiymeri*
***Pranoi:*** *Drejt.Pergj.* *Sh.Çullhaj*

**KRYETARI**

**Gledian Llatja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

# MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

## MIDIS

## BASHKISË ELBASAN,

## DHE

## INCA

***"Për reduktimin e ndotjes nga plastika njëpërdorimëshe, promovimin e praktikave të qëndrueshme mjedisore dhe mbrojtjen e Lumit Shkumbin në kuadër të projektit BeMed+"***

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet **Bashkisë Elbasan**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, **z. Gledian Llatja**, me adresë në Rrugën "Qemal Stafa", Elbasan, me NIPT K52905207B, email: bashkiaelbasan@elbasani.gov.al, dhe **INCA**, në cilësinë e organizatës koordinuese dhe implementuese lokale të **autorizuar** nga **BeMed+** për Shqipërinë, përfaqësuar nga **z. Genti Kromidha**, me seli në Rrugën Islam Alla, pallati IVEA, kati i parë, Tiranë, me NIPT K52409010O, email: info@inca-al.org dhe tel: +355682071979.

## BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje mbështetet në: Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar; Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar; Ligjin nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar; legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbetjeve dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm;

si dhe në kompetencat që u njihen njësive të vetëqeverisjes vendore për ndërmarrjen e nismave dhe lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të mbrojtjes së mjedisit, ndërgjegjësimit qytetar dhe interesit publik.

## PREAMBULË

Duke marrë në konsideratë se **projekti BeMed+** mbështetet financiarisht nga **FFEM** dhe synon reduktimin e ndotjes nga mbetjet plastike në rajonin e Mesdheut përmes ndërhyrjeve konkrete, rritjes së ndërgjegjësimit publik dhe promovimit të praktikave të qëndrueshme mjedisore;

Duke vlerësuar se lumenjtë përbëjnë një nga rrugët kryesore përmes të cilave mbetjet plastike arrijnë në det, duke transportuar mbetje nga zonat urbane dhe rurale drejt brigjeve;

Duke njohur se Lumi Shkumbin, i cili përshkon territorin e Bashkisë Elbasan dhe derdhet në Detin Adriatik, pjesë e Detit Mesdhe, ka një rol të drejtpërdrejtë në gjendjen e ekosistemit detar dhe se reduktimi i ndotjes plastike në këtë lumë kontribuon në përmirësimin e biodiversitetit dhe shëndetit të detit;

Duke theksuar përgjegjësinë dhe rolin e njësive të vetëqeverisjes vendore në menaxhimin e mbetjeve, organizimin e fushatave të pastrimit, vendosjen e infrastrukturës për ndarjen e mbetjeve plastike, si dhe në ndërgjegjësimin e komunitetit dhe aktorëve lokalë për reduktimin e ndotjes dhe ndryshimin e sjelljes qytetare;

Duke pranuar se çdo veprim i ndërmarrë në nivel lokal për reduktimin e plastikës ka ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e lumenjve dhe të Detit Mesdhe;

Duke konsideruar se ky bashkëpunim përbën një mundësi për të testuar dhe promovuar praktika të mira që mund të shërbejnë si model edhe për bashki të tjera në Shqipëri;

Palët bien dakord si më poshtë:

**NENI 1**

**Qëllimi i Marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është formalizimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe INCA, në kuadër të projektit BeMed+, për planifikimin dhe zbatimin e masave që synojnë:

a) reduktimin e përdorimit të produkteve plastike njëpërdorimëshe;
b) përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve plastike;
c) rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe edukimit mjedisor;
d) promovimin e alternativave të ripërdorshme dhe praktikave të qëndrueshme;
e) forcimin e bashkëpunimit institucional dhe komunitar në territorin e Bashkisë Elbasan.

**NENI 2**

**Angazhimet e Bashkisë Elbasan**

Bashkia Elbasan angazhohet:

1. Të bashkëpunojë me INCA dhe partnerët e projektit BeMed+ në hartimin dhe zbatimin e masave lokale për reduktimin e ndotjes plastike.
2. Të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes së praktikave të qëndrueshme në dokumentet strategjike, planet vendore dhe aktet administrative përkatëse.

3. Të mbështesë, sipas mundësive logjistike dhe organizative, zhvillimin e fushatave të pastrimit, aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe nismave komunitare.
4. Të bashkëpunojë për identifikimin e hapësirave publike për vendosjen e pajisjeve dhe infrastrukturës mbështetëse në kuadër të projektit.
5. Të inkurajojë pjesëmarrjen e administratës bashkiake në trajnimet dhe aktivitetet informuese të organizuara në kuadër të kësaj marrëveshjeje.
6. Të kontribuojë me informacion institucional dhe të dhëna të nevojshme për monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të projektit.
7. Të caktojë personat e kontaktit dhe strukturat përgjegjëse për koordinimin teknik dhe administrativ të marrëveshjes.
8. Të nxisë bashkëpunimin me shkollat, komunitetin, bizneset dhe organizatat lokale për mbështetjen e objektivave të projektit.

**NENI 3**

**Angazhimet e INCA / Projektit BeMed+**

INCA, në cilësinë e organizatës koordinuese dhe implementuese lokale të autorizuar në Shqipëri për projektin BeMed+, angazhohet:

1. Të ofrojë asistencë teknike dhe ekspertizë profesionale për hartimin dhe zbatimin e masave që lidhen me reduktimin e produkteve plastike njëpërdorimëshe dhe menaxhimin e mbetjeve plastike.
2. Të mbështesë Bashkinë Elbasan me rekomandime teknike, modele praktike dhe praktika të mira vendase dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe ekonomisë qarkulluese.
3. Të sigurojë, sipas buxhetit të projektit, procedurave përkatëse dhe fondeve të disponueshme, pajisje, materiale ndërgjegjësuese, mjete logjistike dhe elementë të tjerë mbështetës për realizimin e aktiviteteve të planifikuara.
4. Të organizojë ose bashkëorganizojë fushata sensibilizuese, aktivitete komunitare, trajnime, workshop-e dhe sesione informuese për administratën vendore, shkollat, komunitetin dhe aktorë të tjerë lokalë.
5. Të mbështesë aktivitete monitorimi, evidentimi dhe mbledhjeje të të dhënave mjedisore në bashkëpunim me institucionet dhe strukturat kompetente.
6. Të përgatisë raporte periodike mbi ecurinë e aktiviteteve, rezultatet e arritura dhe zbatimin e komponentëve të projektit në territorin e Bashkisë Elbasan.
7. Të koordinojë komunikimin me partnerët dhe strukturat e projektit BeMed+, si dhe të informojë Bashkinë Elbasan mbi aktivitetet, afatet dhe zhvillimet përkatëse që lidhen me zbatimin e projektit.
8. Të sigurojë koordinimin teknik dhe financiar të aktiviteteve të projektit BeMed+ në territorin e përcaktuar në kuadër të mandatit të dhënë nga organizata Beyond Plastic Med (BeMed) dhe marrëveshjeve me donatorin.

## NENI 4

### Aspektet Financiare

1. Kjo marrëveshje nuk krijon detyrime financiare, bashkëfinancim të detyrueshëm apo angazhime buxhetore për Bashkinë Elbasan.
2. Roli i Bashkisë Elbasan në kuadër të kësaj marrëveshjeje është institucional, koordinues dhe mbështetës, në përputhje me kompetencat ligjore dhe mundësitë organizative të saj.
3. Çdo mbështetje financiare, materiale, teknike ose logjistike që ofrohet në kuadër të projektit BeMed+ realizohet nga INCA dhe/ose partnerët e projektit, sipas fondeve të disponueshme, procedurave përkatëse dhe planit të aktiviteteve të miratuara në Aneksin 1 të kësaj marrëveshjeje.
4. Pajisjet, materialet dhe mbështetja e ofruar në kuadër të projektit BeMed+ do të administrohen dhe përdoren sipas dakordësisë ndërmjet palëve dhe rregullave përkatëse të projektit.

## NENI 5

### Kohëzgjatja

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Elbasan dhe nënshkrimit nga palët, dhe mbetet e vlefshme deri më 31 dhjetor 2027.
2. Afati i kësaj marrëveshjeje mund të zgjatet, rinovohet ose të ndryshohet me dakordësi të ndërsjellë me shkrim ndërmjet palëve, në varësi të ecurisë së bashkëpunimit, rezultateve të arritura dhe vijimësisë së projektit BeMed+.
3. Në rast përfundimi të projektit përpara afatit të parashikuar ose në rast rrethanash të tjera objektive që ndikojnë në zbatimin e saj, palët mund të rishikojnë kohëzgjatjen e marrëveshjes me mirëkuptim reciprok.

## NENI 6

### Konfidencialiteti

1. Palët angazhohen të respektojnë konfidencialitetin e informacionit, dokumenteve, të dhënave jo publike dhe materialeve të shkëmbyera gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe rregullat e brendshme të secilës palë.
2. Informacioni i marrë në kuadër të kësaj marrëveshjeje përdoret vetëm për qëllimet e bashkëpunimit dhe nuk u transmetohet palëve të treta pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës përkatëse, përveç rasteve të parashikuara nga ligji.
3. Publikimi i raporteve, materialeve promovuese, të dhënave teknike, njoftimeve publike apo çdo informacioni që lidhet me palën tjetër bëhet me konsultim paraprak dhe

dakordësi reciproke, përveç rasteve kur detyrimi i publikimit rrjedh nga legjislacioni në fuqi.

4. Detyrimet e këtij neni vijojnë të mbeten në fuqi edhe pas përfundimit ose ndërprerjes së kësaj marrëveshjeje, për aq sa parashikohet nga natyra e informacionit dhe kuadri ligjor përkatës.

## NENI 7

## Monitorimi dhe Raportimi

1. Palët angazhohen të ndjekin zbatimin e kësaj marrëveshjeje përmes komunikimit periodik, takimeve koordinuese, shkëmbimit të informacionit dhe vlerësimit të rregullt të ecurisë së aktiviteteve të realizuara.
2. Raportimi mbi progresin e aktiviteteve do të përgatitet periodikisht nga palët, sipas roleve dhe përgjegjësive përkatëse, duke u mbështetur në dokumentacionin administrativ, evidencat teknike, aktivitetet e zhvilluara, treguesit e performancës dhe rezultatet e arritura.
3. Për qëllime të monitorimit, palët mund të përcaktojnë persona kontakti ose grupe pune teknike për ndjekjen e realizimit të aktiviteteve dhe zgjidhjen e çështjeve operative që mund të lindin gjatë zbatimit të marrëveshjes.
4. Për koordinimin teknik dhe institucional të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, Bashkia Elbasan cakton si **pikë kontakti** Drejtorinë e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Statistikave dhe Performancës, të përfaqësuar nga drejtoresha **znj. Lorena Haxhiymeri**.
5. Aneksi 1, që përmban planin orientues të aktiviteteve dhe afateve, është pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje dhe shërben si instrument reference për monitorimin e zbatimit, me mundësi rishikimi sipas nevojave konkrete të projektit dhe dakordësisë ndërmjet palëve.

## NENI 8

## Pjesëmarrja në Trajnime

1. Bashkia Elbasan, sipas nevojave institucionale dhe mundësive organizative, do të inkurajojë pjesëmarrjen e punonjësve të saj, strukturave vartëse dhe përfaqësuesve të autorizuar në trajnimet, workshop-et dhe aktivitetet informuese të organizuara në kuadër të kësaj marrëveshjeje.
2. Pjesëmarrja në këto aktivitete realizohet pa kosto shtesë për Bashkinë Elbasan, për aq sa mbulohen nga projekti BeMed+, INCA ose organizatorët përkatës.
3. Tematikat e trajnimeve mund të përfshijnë menaxhimin e mbetjeve plastike, ekonominë qarkulluese, edukimin mjedisor, komunikimin publik dhe praktikat e qëndrueshme institucionale.

## NENI 9

**Mbështetja Teknike dhe Materiale**

1. Pas vlerësimit fillestar të nevojave dhe prioriteteve lokale, INCA / projekti BeMed+ mund të ofrojë mbështetje teknike, logjistike ose materiale për realizimin e masave prioritare, në përputhje me planin e projektit dhe fondet e disponueshme.
2. Kjo mbështetje mund të përfshijë pajisje teknike, kosha të dedikuar, materiale ndërgjegjësuese, elementë informues, mjete komunikimi dhe materiale promocionale.
3. Lloji, sasia dhe mënyra e përdorimit të mbështetjes së ofruar përcaktohen me dakordësi ndërmjet palëve, sipas nevojave konkrete dhe mundësive reale të projektit.

**NENI 10**

**Përputhja me Kuadrin Ligjor**

1. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të realizohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe dokumentet strategjike që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve.
2. Asnjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje nuk interpretohet si shmangie apo zëvendësim i procedurave ligjore, administrative dhe financiare të detyrueshme për secilën palë.
3. Në rast ndryshimesh të legjislacionit që ndikojnë në zbatimin e marrëveshjes, palët angazhohen të konsultohen për përshtatjen e dispozitave përkatëse.

**NENI 11**

**Përfundimi dhe Ndërprerja e Marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje përfundon me mbarimin e afatit të përcaktuar në të ose mund të ndërpritet më herët nga secila palë me njoftim me shkrim drejtuar palës tjetër të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara.
2. Në rast moszbatimi të detyrimeve thelbësore të përcaktuara në këtë marrëveshje, palët angazhohen fillimisht të zhvillojnë konsultime dhe përpjekje me mirëkuptim për zgjidhjen e situatës përpara ndërprerjes së saj.
3. Ndërprerja e kësaj marrëveshjeje nuk cenon vlefshmërinë e aktiviteteve dhe procedurave të nisura gjatë periudhës së zbatimit të saj, përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe me shkrim.

**NENI 12**

**Dispozita Përfundimtare**

1. Kjo marrëveshje ka karakter bashkëpunues dhe nuk krijon marrëdhënie kontraktuale tregtare ndërmjet palëve.

2. Çdo ndryshim ose shtesë në këtë marrëveshje bëhet vetëm me dakordësi të ndërsjellë me shkrim ndërmjet palëve.
3. Aneksi 1 "Kalendari i Aktiviteteve 2026–2027" është pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.
4. Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale, me të njëjtën fuqi ligjore, nga të cilat secila palë mban një kopje.
5. Kjo marrëveshje nuk transferon kompetenca ligjore, përgjegjësi administrative apo detyrime financiare nga njëra palë tek tjetra.

***__Konceptoi:__*** *DPBPMSP* *L.Haxhiymeri*
***__Pranoi:__*** *Drejt.Pergj.* *Sh.Çullhaj*
***Pranoi:*** *Drejt Juridike* *A.Hoxha*

**NËNSHKRIMET**

| | |
|---|---|
| **PËR** | **PËR** |
| **Bashkinë Elbasan** | **INCA** |
| **KRYETARI I BASHKISË** | **PRESIDENT** |
| **Gledian Llatja** | **Genti Kromidha** |
| Datë: ___________________ | Datë: ___________________ |
| Firma: __________________ | Firma: __________________ |

BEYOND PLASTIC MED

FONDS FRANÇAIS POUR L'ENVIRONNEMENT MONDIAL

# Aneks 1 – Kalendari i Aktiviteteve (2026–2027)

Ky Aneks është pjesë integrale e Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe përshkruan rrjedhën e aktiviteteve të planifikuara për periudhën 2026–2027. Ai shërben si udhërrëfyes praktik për zbatimin e masave të kuadrit logjik, duke përcaktuar kohën, përgjegjësitë dhe rezultatet e pritshme.

Në vitin 2026, aktivitetet do të përqendrohen në **krijimin e bazës institucionale dhe teknike**: miratimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve Plastike, vendimet e Këshillit Bashkiak për prokurime pa plastikë, hartimi i hartës së pikave të ndotjes dhe nisja e fushatave të para pastruese. Paralelisht, do të vendosen stacionet e mbushjes me ujë dhe do të shpërndahen materiale të ripërdorshme për komunitetin.

Në vitin 2027, fokusi zhvendoset tek **ndërgjegjësimi dhe konsolidimi i praktikave**: instalimi i koshave në shkolla dhe hapësira publike, trajnimi i stafit bashkiak, fushatat e pastrimit të radhës, vendosja e tabelave sinjalizuese dhe angazhimi i figurave publike për të përforcuar mesazhin. Testet e cilësisë së ujit dhe raportet përfundimtare do të sigurojnë transparencë dhe matje të rezultateve.

| Periudha | Aktiviteti Kryesor | Masa | Përgjegjësitë |
|---|---|---|---|
| Maj-Korrik 2026 | Përgatitja dhe miratimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve Plastike | 1.1 | Bashkia + Ekspertët |
| Qershor-Korrik 2026 | Vendimi i Këshillit Bashkiak për prokurime pa plastikë | 1.1 | Bashkia |
| Janar-Mars 2027 | Forcimi i kapaciteteve te bashkise për hartëzimin e pikave te ndotjes (blerje drone, GPS), | 1.1 | Bashkia + Organizata |
| Prill- Maj 2027 | Hartimi i hartës së pikave të ndotjes (GPS/Drone) | | |
| Maj-Tetor 2026 | Fushata pastrimi #1 (Shkumbin) | 1.1 | Bashkia + Shkollat + OJF |
| Mars 2027 | Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese në 4 stacione publike të mbushjes me ujë | 1.2 | Bashkia + Organizata |

SURFRIDER FOUNDATION EUROPE

INCA INSTITUTE FOR NATURE CONSERVATION IN ALBANIA

| | | | |
|---|---|---|---|
| Tetor 2026 | Shpërndarja e materialeve promovuese (400 termuse, çanta beze dhe bluza) | 1.2 | Organizata |
| Shtator 2026 | Testi i parë i cilësisë së ujit | 1.2 | Instituti i Shëndetit Publik |
| Shkurt 2027 | Testi i dytë i cilësisë së ujit | 1.2 | Instituti i Shëndetit Publik |
| Maj 2026-Prill 2027 | Fushata ndërgjegjësimi #1 (shkolla + media lokale) | 1.2–1.3 | Bashkia + Organizata |
| Nëntor 2026-Prill 2027 | 10 kosha për shishe plastike në zonat publike | 1.1 | Bashkia + Organizata |
| Nëntor 2026-Janar 2027 | Instalimi i 100 koshave në shkolla | 1.1 | Bashkia + Organizata |
| Nëntor 2026-Janar 2027 | Instalimi i 1 koshi ne shkolla për kapakët e shisheve plastike | 1.1 | Bashkia + Organizata |
| Korrik 2026 | Trajnimi i stafit bashkiak (≥50% pjesëmarrje) | 1.1 | Organizata |
| Mars 2027 | Fushata pastrimi #2 | 1.1 | Bashkia + OJF |
| Shkurt-Prill 2027 | Instalimi i tabelave sinjalizuese dhe ndërgjegjësuese përgjatë lumit dhe në qytet dhe prezantimi publik i progresit | 1.3 + Të gjitha | Bashkia + Organizata |

Monaco, 28th of April 2026

To Whom it may concern,

The Association Beyond Plastic Med "BeMed", registered in Monaco on 18 January 2019, confirms with this letter the role of the Institute for Nature Conservation in Albania (INCA) as local coordinator for the project BeMed+.

The BeMed+ project was accepted by the FFEM (Fonds Français pour l'Environnement Mondial) on 20 June 2023 by resolution no. 2023 0006 of the FFEM Steering Committee and signed on 23 January 2024. It started in January 2024 and will finish on the 31st of December 2027.

The INCA is responsible for the coordination and the implementation of the actions for the pilot geographical area in Albania (along the Shkumbin river basin, including the Elbasan and Librazhd Municipalities) as well as for the technical and financial reporting of these activities.

Yours sincerely.

Lucile Courtial,

BeMed executive Secretary

BeMed
Beyond Plastic Med
NIS 9499Z20733

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**Këshilli Bashkiak**

**Nr._________ Prot.** **Elbasan, më____.____. 2026**

## P R O J E K T   V E N D I M

Nr.___, datë ___.___.2026

***"PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET BASHKISË ELBASAN DHE INCA NË KUADËR TË PROJEKTIT BeMed+"***

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbështetje të nenit 8, nenit 9 pika 1.6 shkronja "a", nenit 54 shkronja "dh" dhe nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", ligjit nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", si dhe pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Statistikave dhe Performancës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet **Bashkisë Elbasan** dhe organizatës **INCA**, në kuadër të **projektit "BeMed+"**, për reduktimin e ndotjes nga plastika njëpërdorimëshe, promovimin e praktikave të qëndrueshme mjedisore dhe mbrojtjen e **Lumit Shkumbin**, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Elbasan për nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit me organizatën INCA.
3. Ngarkohet Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Statistikave dhe Performancës për koordinimin teknik dhe institucional të zbatimit të marrëveshjes.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

***Konceptoi:*** *DPBPMSP* *L.Haxhiymeri*
***Pranoi:*** *Drejt.Pergj.* *Sh.Çullhaj*
***Pranoi:*** *Drejt Juridike* *A.Hoxha*

**Sekretari**
**Elsid Zyma**

**Kryetar**
**Lutfi LALA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E POLITIKAVE TË BUJQËSISË, PYJEVE, MJEDISIT, STATISTIKAVE DHE PERFORMANCËS
SEKTORI I STATISTIKAVE DHE PERFORMANCËS

Nr. 2825 prot. Elbasan, më 18.05.2026

# Relacion

***"PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË BASHKISË ELBASAN "***

**Drejtuar:** **KËSHILLIT BASHKIAK**

**Relacioni shpjegues**

Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, nenit 6 të tij, ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, si dhe Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore", Bashkia Elbasan propozon për miratim Programin Institucional të Transparencës të Bashkisë Elbasan, sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri.

Programi i Transparencës synon forcimin e transparencës aktive institucionale, rritjen e aksesit të qytetarëve në informacion publik, përmirësimin e llogaridhënies administrative dhe financiare, si dhe garantimin e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse të Bashkisë Elbasan.

Ky program vjen si nevojë për përshtatjen e praktikave institucionale të Bashkisë Elbasan me standardet e reja kombëtare të transparencës dhe qeverisjes së hapur, duke zëvendësuar Programin e mëparshëm të Transparencës të miratuar sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018, i cili është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Programi i ri Institucional i Transparencës përfaqëson një instrument të rëndësishëm për forcimin e qeverisjes së hapur në nivel vendor dhe lidhet drejtpërdrejt me:

- transparencën aktive të institucionit;
- konsultimin publik dhe pjesëmarrjen qytetare;

- rritjen e integritetit institucional;
- publikimin proaktiv të informacionit publik;
- standardet e Open Government Partnership (OGP);
- dhe forcimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve vendore.

Programi është i strukturuar në 8 fusha kryesore, të cilat mbulojnë të gjithë veprimtarinë institucionale të Bashkisë Elbasan:

**FUSHA 1**

**Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë Elbasan**

Kjo fushë përfshin publikimin e informacionit mbi:

- organizimin administrativo-territorial;
- misionin dhe funksionet e Bashkisë;
- strukturën administrative;
- rregulloret e funksionimit;
- strukturën e pagave;
- auditimin e brendshëm dhe të jashtëm;
- mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit;
- procedurat e ankesave dhe sinjalizimeve;
- si dhe statistikat vendore sipas fushave kryesore të përgjegjësisë.

**FUSHA 2**

**Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare**

Kjo fushë përcakton detyrimin për publikimin e:

- paketës fiskale;
- programit buxhetor afatmesëm;
- buxhetit vjetor;
- treguesve financiarë;
- raporteve të monitorimit të buxhetit;
- realizimit të procedurave të prokurimit publik;
- kontratave publike;
- donacioneve;
- si dhe informacionit mbi përdorimin e fondeve publike.

**FUSHA 3**

**Kërkesat për informim**

Kjo fushë përfshin:

- publikimin e të dhënave funksionale të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;
- procedurat standarde për paraqitjen e kërkesave për informacion;
- regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve;
- afatet ligjore të trajtimit të kërkesave;
- si dhe tarifat për dhënien e informacionit, në rastet kur ato aplikohen.

**FUSHA 4**

**Shërbimet që ofron Bashkia Elbasan**

Në këtë fushë përfshihet publikimi i:

- listës së shërbimeve administrative dhe publike;
- procedurave për përfitimin e tyre;
- tarifave përkatëse;
- strukturave përgjegjëse;
- standardeve të ofrimit të shërbimeve;
- si dhe të dhënave mbi monitorimin dhe performancën e shërbimeve.

**FUSHA 5**

**Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore**

Kjo fushë kërkon publikimin e:

- legjislacionit kombëtar të zbatueshëm;
- akteve nënligjore;
- vendimeve të Këshillit Bashkiak;
- urdhrave dhe urdhëresave të Kryetarit të Bashkisë;
- dokumenteve strategjike vendore;
- si dhe akteve të tjera me karakter normativ.

**FUSHA 6**

**Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje**

Kjo fushë përcakton detyrimin për:

- publikimin e njoftimeve për konsultim publik;
- planit vjetor të konsultimeve;

- projektakteve dhe dokumenteve shoqëruese;
- procedurave për paraqitjen e komenteve dhe rekomandimeve;
- raporteve mbi rezultatet e konsultimeve publike;
- si dhe publikimin e raportit vjetor mbi transparencën në procesin e vendimmarrjes.

**FUSHA 7**

**Informacion tjetër**

Në këtë fushë përfshihet publikimi i:

- informacionit mbi projektet dhe iniciativat në kuadër të integrimit europian;
- të dhënave mbi bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile;
- raporteve, studimeve dhe vlerësimeve mbi Programin e Transparencës;
- si dhe iniciativave monitoruese dhe advokuese të aktorëve të ndryshëm lokalë.

**FUSHA 8**

**Këshilli Bashkiak**

Kjo fushë përfaqëson një nga risitë kryesore të Programit të ri të Transparencës dhe kërkon publikimin e:

- listës së këshilltarëve bashkiakë;
- biografive të tyre;
- kontakteve zyrtare;
- informacionit mbi komisionet e këshillit;
- njoftimeve për mbledhjet;
- projektakteve dhe dokumenteve për diskutim;
- procesverbaleve dhe vendimeve të miratuara;
- konsultimeve publike të Këshillit Bashkiak;
- si dhe kuadrit rregullator të funksionimit të tij.

Në përputhje me pikën 3 të Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të zbatojnë Programin Institucional të Transparencës jo më vonë se data 31 mars 2026.

Programi i Transparencës do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan: **Bashkia Elbasan** www.elbasani.gov.al si dhe në këndet e njoftimeve publike të institucionit dhe njësive administrative. Monitorimi dhe koordinimi ndërdrejtorial për zbatimin e Programit të Transparencës do të kryhet nga Koordinatorja e Performancës dhe të Dhënave të Hapura, znj. Lorena Haxhiymeri.

Miratimi i këtij programi përbën një hap të rëndësishëm drejt forcimit të transparencës institucionale, llogaridhënies publike dhe garantimit të së drejtës së qytetarëve për informim, në përputhje me standardet e qeverisjes së hapur dhe administrimit modern vendor.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i Programit të Transparencës së Bashkisë Elbasan, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij relacioni.

***Konceptoi:*** *DPBPMSP* *L.Haxhiymeri*
***Pranoi:*** *Drejt.Pergj.* *Sh.Çullhaj*
***Pranoi:*** *Drejt Juridike* *A.Hoxha*

**KRYETARI**

**Gledian Llatja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 3329 prot. Tiranë, më 30.12.2025

**URDHËR**

**Nr. 281, datë 30.12.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROGRAMIT MODEL TË TRANSPARENCËS PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 6 të ligjit nr. 119/2014 *"Për të drejtën e informimit"*, i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Programit model të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, bashki dhe këshilla qarqesh.
3. Autoritetet publike të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, zbatojnë Programin institucional të Transparencës, sipas formës dhe përmbajtjes në përputhje me lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri, jo më vonë se data 31 mars 2026.
4. Urdhri nr. 211, datë 10.09.2018 *"Për miratimin e programit të transparencës të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"* shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

Adresa: "Rr. Abdi Toptani, Nd.5 Tiranë". Telefon:00355 42237200
www.idp.al info@idp.al

Lidhja nr. 1

# PROGRAMI I TRANSPARENCËS PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

## TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS

[*Vendos emrin e njësisë së vetëqeverisjes vendore (NJVV)*]

| **Fusha 1 - Mbi organizimin dhe funksionimin e NJVV** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Informacioni që bëhet publik pa kërkesë | Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni | Afati kohor për publikim | Organi miratues | Organi përgjegjës për publikimin |
| 1 | **Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet.** NJVV bën publike:<br>1. **Ndarjen administrativo-territoriale**<br>- Njësitë administrative dhe nën-ndarjet e tyre<br>2. **Të drejtat, përgjegjësitë dhe misionin e NJVV.**<br>3. **Funksionet**: Përfshin bërjen publike të:<br>- Funksioneve në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike<br>- Funksioneve në fushën e shërbimeve sociale<br>- Funksioneve në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese<br>- Funksioneve në fushën e mbrojtjes së mjedisit<br>- Funksioneve në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit<br>- Funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik vendor<br>- Funksioneve në fushën e sigurisë publike<br>- Funksionet dhe kompetencat e deleguara | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link)<br><br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Menjëherë | Sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. | Titullari i NJVV |
| 2 | **Organi ekzekutiv** (Titullari i NJVV). Përfshin bërjen publike të: | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | - Procedurave të zgjedhjes<br>- Detyrat dhe kompetencat<br>- Të dhënat për arsimin, kualifikimet , paga e Titullarit dhe deklarimi i pasurisë<br>- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ<br>- Orari i pritjes së qytetarëve<br>- Adresa postare/ elektronike | | | | |
| 3 | **Administrata e NJVV.** Përfshin bërjen publike të:<br>- Strukturës organizative dhe numrin e punonjësve<br>- Rregullores së organizimit dhe funksionimit të administratës<br>- Strukturës së pagave<br>- Orarit të punës së NJVV, njësive administrative dhe njësive të varësisë<br>- Detyrave të administratës së njësive administrative<br>- Organizimit dhe funksionimit të njësive në varësi<br>- Njoftimeve mbi vende të lira pune dhe procedurat e rekrutimit<br>- Adresave postare dhe elektronike e zyrave të NJVV/njësive administrative/ njësive në varësi të NJVV<br>- Drejtuesit e zyrave, njësive administrative dhe njësive të varësisë | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Menjëherë | Titullari i NJVV | Sekretari i përgjithshëm i NJVV |
| 4 | **Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit.** Përfshin bërjen publike të:<br>- Kartës së Auditimit të Brendshëm<br>- Kodit të Etikës për audituesit e brendshëm<br>- Planit strategjik dhe vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm<br>- Çdo raporti të auditimit të brendshëm të ushtruar në NJVV<br>- Çdo raporti përfundimtar të kontrollit të jashtëm (KLSH) të ushtruar në NJVV | a) Në faqen zyrtare të internetit - menuja……..(me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | - Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm | | | | |
| 5 | **Kërkesa, ankesa, sinjalizime dhe vërejtje që lidhen me** veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës. Përfshin bërjen publike të:<br>- Procedurave për të bërë kërkesë, ankesë, vërejtje dhe sinjalizime organeve të NJVV<br>- Rregullores së brendshme për procedurën e shqyrtimit, të hetimit administrativ, të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit<br>- Njësisë përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet<br>- Adresave postare/ elektronike për depozitimin e kërkesave, ankesave, sinjalizimeve apo vërejtjeve<br>- Afateve dhe mënyrave të kthimit të përgjigjeve në lidhje me kërkesat, ankesat apo vërejtjet | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link)<br><br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Menjëherë | Titullari i NJVV | Sekretari i përgjithshëm i NJVV |
| 6 | **Statistikat vendore**. Përfshin bërjen publike të:<br>- Kalendarit të publikimit të statistikave vendore<br>- Statistikave vendore me të dhënat kyçe të NJVV sipas fushave kryesore dhe të ndara sipas gjinisë<br>- Strukturës përgjegjëse në NJVV për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore | a)Në faqen zyrtare të internetit - menuja........(me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Menjëherë pas miratimit | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| **Fusha 2 - Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare** | | | | | |
| **Nr.** | **Informacioni që bëhet publik pa kërkesë** | **Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni** | **Afati kohor për publikim** | **Organi miratues** | **Organi përgjegjës për publikimin** |
| 1 | **Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor** | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Në 10 ditëshin e parë të janarit | Këshilli i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2 | **Paketa fiskale (taksa dhe tarifa).** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Bazës së taksave dhe tarifave<br>2. Nivelit të taksave dhe tarifave<br>3. Përjashtimeve dhe lehtësimeve të subjekteve të caktuara<br>4. Afateve të pagesave<br>5. Gjobave dhe kamatëvonesave të aplikueshme | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve)<br>c)Botohen (citohet botimi) | Brenda 15 ditëve nga miratimi | Këshilli i NJVV | Titullari i NJVV |
| 3 | **Plani Strategjik i Zhvillimit të NJVV.** Përmban:<br>1. Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm në një afat kohor jo më pak se 5 vite<br>2. Synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësi<br>3. Veprimet që duhen ndërmarrë duke parashikuar edhe kostot përkatëse<br>4. Burimet e financimit | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link) | 10 ditë nga data e miratimit | Këshilli i NJVV | Titullari i NJVV |
| 4 | **Programi buxhetor afatmesëm vendor.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Dokumentit të parë të programit buxhetor<br>2. Dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm<br>3. Dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm (përfshirë dokumentacionin shoqërues) dhe informacionit për dy vitet e fundit, vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese për çdo program (5 dokumentat përkatës) | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Dokumenti i parë brenda datës 5 korrik.<br>Dokumenti i rishikuar.<br>Dokumenti i plotë jo më vonë se data 31 dhjetor. | Këshilli i NJVV | Titullari i NJVV |
| 5 | **Buxheti.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Buxhetit vjetor së bashku me dokumentacionin shoqërues të tij (12 dokumentat përkatës)<br>2. Treguesve financiarë<br>3. Numrit të punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese<br>4. Regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik | a) Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve)<br>c) Në Buletinin e Njoftimeve Publike | 15 ditë pas miratimit nga Këshilli i NJVV.<br>Regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit. | Këshilli i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | **Zbatimi i buxhetit.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Raportit mujor (pas datës 30 prill të çdo viti buxhetor) të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve<br>(8 raporte) | a) Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës | Titullari i NJVV<br><br>Informohet Këshilli i NJVV | Titullari i NJVV |
| 7 | **Monitorimi dhe mbikëqyrje** e buxhetit:<br>1. Raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit (jo më pak se tre raporte katër-mujore)<br>2. Raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit<br>2.1. Raportit të performancës vjetore<br>2.2. Pasqyrave financiare vjetore (dokumentacionin bazë dhe shoqërues)<br>3. Informacionit për zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punëve publike, mallrave, shërbimeve)<br>4. Regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit publik | a) Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Raportet e monitorimit brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit.<br><br>Raporti vjetor i konsoliduar brenda muajit qershor të vitit buxhetor pasardhës.<br><br>Regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit publik jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator dhe 10 janar të çdo viti. | Raportet e monitorimit të zbatimit.<br>Titullari i NJVV (Informohet Këshilli i NJVV-së)<br><br>Raporti vjetor i konsoliduar miratohet nga këshilli i NJVV.<br><br>Regjistri i realizimeve të prokurimit. Titullari i NJVV (Informohet Këshilli i NJVV) | Titullari i NJVV |
| 8 | **Vështirësitë financiare.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Planit për daljen nga situata e vështirë financiare | a) Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga shpallja. | Këshilli NJVV | Titullari i NJVV-së |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | c) Në Buletinin e Njoftimeve Publike | | | |
| 9 | **Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe aseteve** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Aseteve dhe pronave të ofruara për shitje ose dhënie me qira<br>2. Kritereve që duhet të plotësohen | a) Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve)<br>c) Në Buletinin e Njoftimeve Publike | | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| 10 | **Donacionet.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Emrit të donatorit<br>2. Shumës së donacionit<br>3. Qëllimit e donacionit | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Menjëherë | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| **Fusha 3- Për kërkesat për informim** | | | | | |
| **Nr.** | **Informacioni që bëhet publik pa kërkesë** | **Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni** | **Afati kohor për publikim** | **Organi miratues** | **Organi përgjegjës për publikimin** |
| 1 | **Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit (Emri, kontaktet dhe kompetencat)** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Emrit mbiemrit të Koordinatorit<br>2. Adresës postare/elektronike të tij<br>3. Orarit të punës<br>4. Detyrave dhe kompetencave të Koordinatorit Adresës postare/elektronike për depozitimin e kërkesave për informim | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Menjëherë | Titullari i NJVV | Koordinatori për të drejtën e informimit |
| 2 | **Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankesës.** Përfshin bërjen publike të: | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link) | Brenda 48 orëve prej miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Koordinatori për të drejtën e informimit |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1. Procedurës që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion<br>2. Adresës postare/elektronike për dërgimin e kërkesës për informim<br>3. Modelit standard të një kërkese për informim<br>4. Afateve të marrjes së përgjigjes<br>5. Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankesë për mos dhënie informacioni<br>Adresës postare/elektronike për dërgimin e ankesës për mos dhënie informacioni | b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | | | |
| 3 | **Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Të gjitha kërkesave për informim<br>2. Informacionet e dhënë në përgjigje të kërkesave për informim<br>Përditësimi i regjistrit | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Menjëherë | Titullari i NJVV | Koordinatori për të drejtën e informimit |
| 4 | **Tarifa për dhënien e informacionin (nëse ka)**<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1. Tarifave<br>2. Rregullave për mënyrën e kryerjes së pagesës<br>Subjekteve që përfitojnë informacionin falas | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve | Menjëherë | Titullari i NJVV | Koordinatori për të drejtën e informimit |
| **Fusha 4 - Mbi shërbimet që ofron NJVV** | | | | | |
| **Nr.** | **Informacioni që bëhet publik pa kërkesë** | **Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni** | **Afati kohor për publikim** | **Organi miratues** | **Organi përgjegjës për publikimin** |
| 1 | **Shërbimet**<br>Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron NJVV sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015<br>1) Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike<br>2) Shërbimet në fushën e shërbimeve sociale<br>3) Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link)<br>b)Vendet e caktuara | Menjëherë | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4) Shërbimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit<br>5) Shërbimet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit<br>6) Shërbimet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor<br>7) Shërbimet në fushën e sigurisë publike<br>8) Shërbimet në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.................<br>Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi:<br>✓ Instrumentin për administrimin e shërbimit<br>✓ Sistemin e administrimit të performancës së shërbimit bazuar mbi standardet<br>✓ Sistemin e treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës<br>✓ Strukturën përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor | për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | | | |
| 2 | **Shërbimet administrative**<br>Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron NJVV sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015<br>1) Shërbimet administrative në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike<br>2) Shërbimet administrative në fushën e shërbimeve sociale<br>3) Shërbimet administrative në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese<br>4) Shërbimet administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit<br>5) Shërbimet administrative në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit<br>6) Shërbimet administrative t në fushën e zhvillimit ekonomik vendor<br>7) Shërbimet administrative në fushën e sigurisë publike<br>Shërbimet administrative në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara<br>Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi: | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link)<br><br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Menjëherë | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | - Strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimit<br>- Adresën postare/elektronike të strukturave/ njësive/sporteleve që ofrojnë shërbime administrative<br>- Procedurat që duhen ndjekur për të përfituar shërbime administrative<br>- Oraret e punës së strukturave/njësive/sporteleve që ofrojnë shërbime administrative<br>- Tarifat për shërbimet administrative<br>- Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës<br>- Subjektet që përjashtohen nga tarifat | | | | |
| 3 | **Kontratat publike**. Përfshin bërjen publike të:<br>- Objektit të kontratës publike<br>- Numrit të referencës së procedurës/ kontratës<br>- Llojit të procedurës<br>- Termave dhe kushteve të kontratës<br>- Kohëzgjatjes së kontratës<br>- Vlerës së kontratës<br>- Dhënave të autoritetit kontraktor<br>- Dhënave të kontraktorit/ nënkontraktorit<br>- Treguesve për matjen e përmbushjes së kontratës<br>- Strukturave publike përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës<br>- Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankimim<br>- Raporteve të kontrollit, monitorimit dhe auditimit mbi zbatimin e kontratës | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Publikimi brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| 4 | **E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet**<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1. Procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet<br>2. Adresës postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja........(me link)<br><br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga shpallja e miratimit | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| **Fusha 5 - Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore** | | | | | |

| Nr. | Informacioni që bëhet publik pa kërkesë | Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni | Afati kohor për publikim | Organi miratues | Organi përgjegjës për publikimin |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore:**<br>1) I organizuar (jo i detyrueshëm) sipas fushave:<br>- Fusha e organizimit dhe funksionimit të NJVV<br>- Fusha e veprimtarisë ekonomiko-financiare<br>- Fusha e qeverisjes së mirë vendore (integriteti, etika, anti-korrupsioni, transparenca, llogaridhënia etj)<br>- Fusha e infrastrukturës dhe shërbimeve publike<br>- Fusha e shërbimeve sociale<br>- Fusha e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese<br>- Fusha e mbrojtjes së mjedisit<br>- Fusha e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit<br>- Fusha e zhvillimit ekonomik vendor<br>- Fusha e sigurisë publike<br>- Fusha e funksioneve dhe kompetencave të deleguara<br>2) Çdo fushë duhet të përmbajë:<br>- Aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse<br>- Dokumentet politike kombëtar përkatës<br>- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit të NJVV-së me karakter normativ<br>- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e Titullarit të NJVV-së me karakter normativ<br>- Dokumentet politike vendor | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare.<br><br>Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit dhe Titullarit të NJVV-së brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Kuvendi i Shqipërisë<br><br>Këshilli i Ministrave<br><br>Ministri<br><br>Këshilli i NJVV<br><br>Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

**Fusha 6 - Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje**

| Nr. | Informacioni që bëhet publik pa kërkesë | Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni | Afati kohor për publikim | Organi miratues | Organi përgjegjës për publikimin |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Emër mbiemër të koordinatorit<br>2. Adresën postare/ elektronike të tij<br>3. Orarin e punës | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b) Vendet e caktuara | Menjëherë pas miratimit të urdhrit të caktimit të Koordinatorit | Titullari i I NJVV | Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | | | |
| 2 | **Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Akteve që do të konsultohen<br>2. Mënyrat e konsultimit<br>3. Afatet<br>Strukturat përgjegjëse | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit | Këshilli i NJVV<br><br>Titullari i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| 3 | **Dispozitat e brendshme rregullatorë për këshillimin me publikun.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Procedurave, afateve dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi<br>Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit | Këshilli i NJVV<br><br>Titullari i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| 4 | **Akte për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Listës së akteve për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Menjëherë | Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| 5 | **Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje**<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1. Projektaktit, relacionin shpjegues dhe dokumentave shoqërues të tij.<br>2. Arsyeve të nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë<br>3. Afatit, vendit dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre; | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Menjëherë | Këshilli i NJVV<br><br>Titullari i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4. Adresën e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të i NJVV ose të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin;<br>5. Vendin dhe datën e organizimit të takimit publik në rastet kur NJVV vendos për organizimin e tij | | | | |
| 6 | **Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Adresën postare/ elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve<br>2. Afatin për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve<br>3. Mënyrën e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit të takimit publik për takimet publike<br>4. Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve<br>Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja........(me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Menjëherë | Këshilli i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| 7 | **Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim** në lidhje me konsultimin publik.<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1. Subjektet ku mund të bëhet ankesa ( Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli i i NJVV, Titullari i i NJVV;)<br>2. Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës<br>3. Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun<br>4. Struktura përgjegjëse në nivel NJVV që regjistron dhe shqyrton ankesën | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja........(me link)<br><br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Menjëherë | Këshilli i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| 8 | **Raporti vjetor për transparencën** në procesin e vendimmarrjes. Përfshin bërjen publike të:<br>1. Numrit të akteve të miratuara nga organet e i NJVV me konsultim publik gjatë një viti.<br>2. Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara; | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja........(me link)<br>b) Vendet e caktuara | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit | Këshilli i NJVV<br><br>Titullari i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 3. Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuara dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes.<br>4. Numrin e takimeve publike të organizuara | për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | | | |
| 9 | **Iniciativa qytetare.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Mënyrës dhe formës së paraqitjes së iniciativës qytetare<br>2. Procedurave të shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare<br>3. Adresës postare/ elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare.<br>Mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mos miratimin e iniciativës qytetare | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit | Këshilli i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| **Fusha 7 - Informacion tjetër** | | | | | |
| **Nr.** | **Informacioni që bëhet publik pa kërkesë** | **Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni** | **Afati kohor për publikim** | **Organi miratues** | **Organi përgjegjës për publikimin** |
| 1 | **NJVV në proceset e integrimit evropian.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Të dhënave për projektet, nismat dhe veprimtarisë e NJVV në kuadrin e integrimit në BE | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| 2 | **Bashkia dhe shoqëria civile.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit<br>2. Të dhëna për OJF, përfaqësuesit e medias, biznesit<br>3. Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme<br>4. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| 3 | **Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të transparencës.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Raporte, studime dhe vlerësime mbi PT<br>2. Sisteme/metodollogji matje të PT | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | | | |
| 4 | **Strukturat komunitare**<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1. Dhënave për strukturat komunitare në fshat<br>2. Dhënave për strukturat komunitare në qytet<br>3. Detyrat, kompetencat dhe kompetencat e strukturave komunitare<br>4. Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| **Fusha 8 – Këshilli Bashkiak** | | | | | |
| **Nr.** | **Informacioni që bëhet publik pa kërkesë** | **Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni** | **Afati kohor për publikim** | **Organi miratues** | **Organi përgjegjës për publikimin** |
| 1 | **Informacion rreth këshilltarëve:** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Lista e këshilltarëve.<br>2. Biografi e shkurtër e këshilltarëve.<br>3. Kontakte të këshilltarëve nr. telefonit/ email-i zyrtar. | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 2 | **Informacion rreth komisioneve:** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Përshkrimi dhe përbërja e komisioneve.<br>2. Njoftim për takimet e komisioneve.<br>3. Agjenda dhe dokumentet për diskutim.<br>4. Raportet e mbledhjeve të komisioneve për projekt-aktet e diskutuara. | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 3 | **Kuadri rregullator i këshillit NJVV:** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Ligje dhe udhëzime për qeverisjen vendore me fokus këshillat.<br>2. Rregullore e funksionimit të këshillit të NJVV-së. | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br>b)Vendet e caktuara | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 3. Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të këshilltarëve NJVVe.<br>4. Rregullore për marrëdhënien e këshillit NJVV me publikun dhe median.<br>5. Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve, dhe iniciativave qytetare. | për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | | | |
| 4 | **Mbledhjet e këshillit:**<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1. Njoftimi paraprak për mbledhjet (data, ora, vendi, agjenda).<br>2. Dokumente përgatitore për mbledhjet.<br>3. Procesverbalet dhe vendimet pas mbledhjeve.<br>4. Mbledhjet live të Këshillit . | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 5 | **Konsultimet publike:** Përfshin bërjen publike të:<br><br>1. Të dhënat e Sekretarit të Këshillit NJVV (Emër Mbiemër, telefon, adresë emaili).<br>2. Plani vjetor i konsultimeve të Këshillit.<br>3. Regjistri i projekt-akteve për konsultim.<br>4. Njoftimi i konsultimeve në faqen e internetit të Këshillit.<br>5. Përmbledhje e pas-konsultimit në raport zyrtar.<br>6. Raporti vjetor i transparencës së konsultime publike/dëgjesave publike. | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 6 | **Vendimet e Këshillit të NJVV:**<br>1. Projekt-Vendimet e Këshillit NJVV<br>2. Vendimet e Këshillit të NJVV (relacionet dhe çdo dokument tjetër bashkëlidhur vendimit). | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 7 | **Kërkesat dhe përgjigjet drejtuar Këshillit NJVV:**<br>1. Procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe ankesës pranë Këshillit NJVV. | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2. Formular për dorëzimin e kërkesave Këshillit NJVV.<br>3. Formular për dorëzimin e ankesave Këshillit NJVV.<br>4. Regjistër i kërkesave dhe përgjigjeve i Këshillit NJVV (përfshirë përgjigjen e dhënë, të anonimizuar) | b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | | | |
| 8 | **Veprimtaria e Këshillit, Komunikimi me Publikun dhe aspekte të tjera:**<br>1. Raporti vjetor i punës së këshillit.<br>2. Buxheti vjetor i këshillit.<br>3. Raporti vjetor i konsoliduar për zbatimin e buxhetit.<br>4. Kalendari vjetor për trajnimet.<br>5. Vlerësim i performancës së këshilltarëve nga aktorë të brendshëm.<br>6. Vlerësim i performancës së këshilltarëve nga OSHC-të.<br>7. Regjistër i peticioneve dhe iniciativave qytetare.<br>8. Deklaratë publike e Titullarit/es së Këshillit për përmirësimin e transparencës.<br>9. Regjistër i OSHC-ve dhe ekspertëve lokalë.<br>10. Statistika | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)<br><br>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**Këshilli Bashkiak**

**Nr.________ Prot.** **Elbasan, më____.____. 2026**

**PROJEKT VENDIM**

Nr.___, datë ___.___.2026

***"PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË BASHKISË ELBASAN"***

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbështetje të nenit 6 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore", si dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Elbasan,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Programit të Transparencës së Bashkisë Elbasan, sipas Lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Programi i Transparencës të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan: www.elbasani.gov.al si dhe në këndet e njoftimeve publike të institucionit dhe njësive administrative.
3. Monitorimi dhe koordinimi ndërdrejtorial për zbatimin e Programit të Transparencës ngarkohet të kryhet nga Koordinatorja e Performancës dhe të Dhënave të Hapura, znj. Lorena Haxhiymeri.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë Elbasan.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

***Konceptoi:*** *DPBPMSP* *L.Haxhiymeri*
***Pranoi:*** *Drejt.Pergj.* *Sh.Çullhaj*
***Pranoi:*** *Drejt Juridike* *A.Hoxha*

**Sekretari**
**Elsid Zyma**

**Kryetar**
**Lutfi LALA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 1834 Prot Datë 19.05.2026

# RELACION

**"Për një shtesë në vendimin e VKB nr 16 dt.29.01.2025 "Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR."**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

*Të nderuar Këshilltarë,*

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore'' i ndryshuar, neni 54, **", të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe** Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,,"

**I-** Komisioni për përcaktimin e normativave të mjeteve motorrike per vitin 2026 i ngritur sipas urdhërit të brendshëm nr.3 dt.06.01.2026 pasi bëri vlerësimin e harxhimit te karburantit për disa pajisje pune, të reja të blera nga ASHPR (sipas procedurave te prokurimit per vitin 2025-2026) hartoj procesverbalin përkatës dhe vendosi që normativat e harxhimit te karburantit të jenë përkatësisht si më poshtë:

| **Nr.** | **Mjeti Motorrik** | **Konsumi i Karburantit** |
|---|---|---|
| 1 | Korrëse bari me benzinë LC 140 P | 1.3 litra/orë benzinë |
| 2 | Motosekë me benzinë BC 500B/50CC | 1.2 litra/orë benzinë |
| 3 | Turrjele toke me benzinë 51.7 cc, 1.4 kw | 1 litër/orë benzinë |
| 4 | Korrëse bari Stihl FS-460 me benzinë cilindri 45,6cc. Fuqia 2,2kw | 1.8 litra/orë benzinë |

**II-**Në vijim të administrimit të mjeteve në përdorim për funksione zyrtare, administratori i Njësisë Administrative Bradashesh, z. Edmond Muça, ka kryer ndryshim të mjetit që përdor në funksion të detyrës.
Konkretisht, mjeti i mëparshëm "Porsche Cayenne", me targë AB893HR, është zëvendësuar me mjetin "Benz GLE", me targë AB888DG.

| Nr | **Targa e mjetit** | **Tipi I mjetit** | **Norma e konsumit** | **Karburanti** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ishte AB893HR | Porsche Chayenne | 10 Litra/100 km | Gaz OiL D1 |
| 2 | U bë AB888DG | Benz GLE | 10 Litra/100 km | Gaz OiL D1 |

Ky ndryshim nuk ndikon në nivelin e konsumit të miratuar të karburantit, i cili mbetet 50 (pesëdhjetë) litra në muaj.

Shenim:Kjo normë e konsumit për Administratorin , miratohet për justifikimin e karburantit të terhequr nga magazina e ASHPR dhe protësimin e fletëudhëtimeve përkatëse

Bashkëngjitur relacionit janë procesverbalet përkatës.

Konceptoi: S.Finance Drilona Mema
P/Sek mekanik Gazmend Gaxhja

Pranoi:Drejtor Drejtorie/ Klaudjo Tusha
Miratoi:Drejtori i Përgjithshëm/Altin Cenolli

**KRYETARI**
**Gledian Llatja**

**Me urdhër e porosi**
**ZV/KRYETAR**
**Klaudja Krasnika**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

**Nr. _____Prot** **Datë ___.___.2026**

**PROJEKTVENDIM**
**Nr. ____ Datë ___.___.2026**
**"Për një shtesë në vendimin e VKB nr 16 dt.29.01.2025 "Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR."**

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore'' i ndryshuar, neni 54, **", të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe** Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,,"
Relacionit të paraqitur nga ASHPR nr.____datë:_________

**VENDOSI :**

1. Të miratojë normën e harxhimit të karburantit për mjetet perkatësisht si më poshtë:.

| Nr. | Mjeti Motorrik | Konsumi i Karburantit |
|---|---|---|
| 1 | Korrëse bari me benzinë LC 140 P | 1.3 litra/orë benzinë |
| 2 | Motosekë me benzinë BC 500B/50CC | 1.2 litra/orë benzinë |
| 3 | Turrjele toke me benzinë 51.7 cc, 1.4 kw | 1 litër/orë benzinë |
| 4 | Korrëse bari Stihl FS-460 me benzinë cilindri 45,6cc. Fuqia 2,2kw | 1.8 litra/orë benzinë |

2. Të miratojë ndryshimin e Automjetit që përdor Administratori Edmond Muça dhe të miratojë normën e karburantit për automjetin e ri

| Nr | Targa e mjetit | Tipi I mjetit | Norma e konsumit | Karburanti |
|---|---|---|---|---|
| 1 | AB888DG | Benz GLE | 10 Litra/100 km | Gaz OiL D1 |

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale _.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi: S.Finance Drilona Mema
P/Sek mekanik Gazmend Gaxhja
Pranoi:Drejtor Drejtorie/ Klaudjo Tusha
Miratoi:Drejtori i Përgjithshëm/Altin Cenolli
Konfirmoi: Zv.Kryetar Klaudia Krasnika

**Sekretari i Këshillit Bashkiak** **Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**ELSID ZYMA** **LUTFI LALA**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN**

**Nr. _____Prot** **Datë ___.___.2026**

**PROJEKTVENDIM**
**Nr. ____ Datë ___.___.2026**
**"Për një shtesë në vendimin e VKB nr 16 dt.29.01.2025 "Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR."**

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore'' i ndryshuar, neni 54, **", të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe** Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,,"
Relacionit të paraqitur nga ASHPR nr.____datë:_________

**VENDOSI :**

1. Të miratojë normën e harxhimit të karburantit për mjetet perkatësisht si më poshtë:.

| **Nr.** | **Mjeti Motorrik** | **Konsumi i Karburantit** |
|---|---|---|
| 1 | Korrëse bari me benzinë LC 140 P | 1.3 litra/orë benzinë |
| 2 | Motosekë me benzinë BC 500B/50CC | 1.2 litra/orë benzinë |
| 3 | Turrjele toke me benzinë 51.7 cc, 1.4 kw | 1 litër/orë benzinë |
| 4 | Korrëse bari Stihl FS-460 me benzinë cilindri 45,6cc. Fuqia 2,2kw | 1.8 litra/orë benzinë |

2. Të miratojë ndryshimin e Automjetit që përdor Administratori Edmond Muça dhe të miratojë normën e karburantit për automjetin e ri

| Nr | **Targa e mjetit** | **Tipi I mjetit** | **Norma e konsumit** | **Karburanti** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | AB888DG | Benz GLE | 10 Litra/100 km | Gaz OiL D1 |

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale _.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi: S.Finance Drilona Mema
P/Sek mekanik Gazmend Gaxhja
Pranoi:Drejtor Drejtorie/ Klaudjo Tusha
Miratoi:Drejtori i Përgjithshëm/Altin Cenolli
Konfirmoi: Zv.Kryetar Klaudia Krasnika

**Sekretari i Këshillit Bashkiak** **Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**ELSID ZYMA** **LUTFI LALA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PERGJITHSHME E KULTURES DHE SPORTIT

**Nr. 2869 Prot.** **Elbasan, më 19.05.2026**

# RELACION

"Mbi transferimin e aseteve te Drejtorise se Pergjithshme te Kultures dhe Sportit te Agjensia e Sherbimeve Publike Rurale , Bashkia Elbasan

**KËSHILLIT BASHKIAK**

*Të nderuar Këshilltarë,*

Me Vendim te Keshillit Bashkiak Nr 79 dt 30/07/2024 "Mbi dhenien e te drejtes se shfrytezimit (pa pagese te pasurive me emertimin Stadiumi "Elbasan Arena", AF Elbasanit SH.a " si edhe vendim të Keshillit Bashkiak Elbasan Nr.131, datë 22/10/2023 "Për shfuqizimin e vendimit nr 79 datë30/07/2024 të këshillit bashkiak dhe administrimin e stadiumit "Elbasan Arena" nga Agjensia e Sherbimeve Publike Rurale , është miratuar kalimi i administrimit te stadiumit "Elbasan Arena" dhe ambjenteve te tij ndihmese ne Agjensine e Sherbimeve Publike Rurale .

Nje nga keto ambjente ndihmese ishte edhe kompleksi Shefqet Lamcja i cili administrohej nga ish Klubi Shumesportesh dhe tashme Drejtoria e Pergjithshme e Kultures dhe Sportit e cila menaxhonte asetet e Kompleksit.

Me vendimet e mesiperme , këto ambjente sportive kaluan në vartësi të Drejtorisë se Sherbimeve Publike Rurale.

Nisur nga sa më sipër kërkohet të bëhet transferimi I aseteve sipas tabeles së mëposhtme bashkëlidhur këtij relacioni.

## *PERMBLEDHESE INVENTARIT FIZIK*

(Asetet e ish Klubit Shumesportesh që do ti transferohen Drejtorisë se Sherbimeve Publike Rurale)

| Nr | Pershkrimi I Aseteve | Asete ndare sipas klasifikimit ekonomik | | | | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Llog 214 | Llog 327 | Llog 218 | Llog 212 | |
| 1 | Asetet e Kompleksit Shefqet Lamcja | 570300 | 76200 | | | 646500 |
| | **Totali** | **570300** | **76200** | | | **646500** |

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q. Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Gjithashtu bashkangjitur kësaj kërkese janë dhe fletët e inventarit të firmosuar sipas bilancit 31.12.2025.

Ju faleminderit!

***Konceptoi:***

*Spec/jurist: E.Koka*

*Prgj Sek Sportit : M.Dosti*

*Dr. Administate : H.Sejdini*

*Dr drejtorie: M.Backa*

*Dr I pergjithshem:A.Kovaci*

**ZV/KRYETARI**

Klodiana Bosnika

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA ELBASAN

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. ________ Prot.** **Elbasan, më ___. .2026**

**PROJEKT VENDIM**

***Nr. ______ datë ___. .2026***

***Mbi transferimin e aseteve te Drejtorise se Pergjithshme te Kultures dhe Sportit te Agjensia e Sherbimeve Publike Rurale , Bashkia Elbasan***

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___. .2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithsme e Kulturës dhe Sportit " Mbi transferimin e aseteve nga Drejtoria e Pergjithshme e Kultures dhe Sportit ,Bashkia Elbasan", bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr.10296 datë 08.7.2010 "Për menaxhimin finanaciar dhe kontrollin" (i ndryshuar) dhe në Udhëzimin e MF nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (i ndryshuar),;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë transferimin e aseteve të Drejtorise se Pergjithshme te Kultures dhe Sportit tek Agjensia e Sherbimeve Publike sipas përmbledhëses së inventarit fizik të mëposhtëm:

| Nr | Pershkrimi I Aseteve | Asete ndare sipas klasifikimit ekonomik | | | | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Llog 214 | Llog 327 | Llog 218 | Llog 212 | |
| 1 | Asetet e Kompleksit Shefqet Lamcja | 570300 | 76200 | | | 646500 |
| | **Totali** | **570300** | **76200** | | | **646500** |

**2.**Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Kultures dhe Sportit, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Elsid ZYMA**

______________________

**KRYETARI**

**Lutfi LALA**

______________________

**Konceptoi :**

*Spec/jurist: E.Koka*

*Dr. Administrate : H.Sejdini*

*Prgj Sek te sportit: M.Dosti*

*Dr drejtorie: M.Backa*

*Dr I pergjithshem:A.Kovaci*

*ZV/Kryetar :* K. Krosaka

Liste e Aseteve qe Kalojne nga Drejtoria e pergjithshme ne Agjensise e Sherbimeve Publike Rurale

| Nr | Emertimi | Nr Llog | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera | | | | Data hyrjes |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Llog 214 | Llog 327 | Llog 218 | Llog 213 | |
| 1 | Pompe kit | 214 | cope | 1 | 9900 | 9900 | | | | |
| 2 | VC+sifon | 327 | cope | 8 | 2700 | | 21600 | | | 26/9/2017 |
| 3 | Pompe zhytese | 214 | cope | 1 | 64800 | 64800 | | | | 20/10/2017 |
| 4 | Makine korrese | 214 | cope | | | 225600 | | | | 21/08/2021 |
| 5 | Draper bari | 327 | cope | 2 | 300 | | 600 | | | 19/04/2022 |
| 6 | Kabell | 327 | m | 220 | 150 | | 33000 | | | 19/04/2022 |
| 7 | Lopata | 327 | cope | 2 | 300 | | 600 | | | 19/04/2022 |
| 8 | Karroce Dore | 327 | cope | 1 | 4500 | | 4500 | | | 8/11/2022 |
| 9 | Lopata me bisht | 327 | cope | 2 | 700 | | 1400 | | | 8/11/2022 |
| 10 | Kazma me bisht | 327 | cope | 2 | 500 | | 1000 | | | 8/11/2022 |
| 11 | Lopata me bisht | 327 | cope | 2 | 800 | | 1600 | | | 8/11/2022 |
| 12 | Draper pune | 327 | cope | 2 | 200 | | 400 | | | 8/11/2022 |
| 13 | Kacavide | 327 | cope | 2 | 150 | | 300 | | | 8/11/2022 |
| 14 | Prashajke | 327 | cope | 2 | 700 | | 1400 | | | 8/11/2022 |
| 15 | Pinca | 327 | cope | 2 | 600 | | 1200 | | | 8/11/2022 |
| 16 | Sqepar me bisht | 327 | cope | 2 | 750 | | 1500 | | | 8/11/2022 |
| 17 | Set kriko | 328 | cope | 1 | | | 7100 | | | 31/03/2023 |
| 18 | Motokorrese | 214 | cope | 1 | 270000 | 270000 | | | | 24/04/2024 |
| | **Totali** | | | | | **570300** | **76200** | | **0** | |

*Klubi Shumesportesh Elbasan*

*Flete inventarizimi*

*Elbasan 31/12/2025*

| Nr | Emertimi | Nr Llog | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera | | | | Data hyrjes |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Llog 214 | Llog 327 | Llog 218 | Llog 213 | |
| 1 | Korrese bari | 214 | cope | 1 | 68500 | 68500 | | | | |
| 2 | Pompe kit | 214 | cope | 1 | 9900 | 9900 | | | | |
| 3 | VC+sifon | 327 | cope | 8 | 2700 | | 21600 | | | 26/9/2017 |
| 4 | Pompe zhytese | 214 | cope | 1 | 64800 | 64800 | | | | 20/10/2017 |
| 5 | Makine korrese | 214 | cope | | | 25000 | | | | |
| 6 | Makine korrese | 214 | cope | | | 225600 | | | | 21/08/2021 |
| 7 | Draper bari | 327 | cope | 5 | 300 | | 1500 | | | 19/04/2022 |
| 8 | Kabell | 327 | m | 220 | 150 | | 33000 | | | 19/04/2022 |
| 9 | Lopata | 327 | cope | 6 | 300 | | 1800 | | | 19/04/2022 |
| 10 | Karroce Dore | 327 | cope | 3 | | | 13500 | | | 8/11/2022 |
| 11 | Lopata me bisht | 327 | cope | 6 | | | 4200 | | | 8/11/2022 |
| 12 | Kazma me bisht | 327 | cope | 6 | | | 3000 | | | 8/11/2022 |
| 13 | Lopata me bisht | 327 | cope | 6 | | | 4800 | | | 8/11/2022 |
| 14 | Draper pune | 327 | cope | 6 | | | 1200 | | | 8/11/2022 |
| 15 | Kacavide | 327 | cope | 5 | | | 750 | | | 8/11/2022 |
| 16 | Prashajke | 327 | cope | 6 | | | 4200 | | | 8/11/2022 |
| 17 | Pinca | 327 | cope | 5 | | | 3000 | | | 8/11/2022 |
| 18 | Sqepar me bisht | 327 | cope | 5 | | | 3750 | | | 8/11/2022 |
| 19 | Set kriko | 328 | cope | 1 | | | 7100 | | | 31/03/2023 |
| 20 | Makina Korrese | 214 | cope | 3 | 40000 | 120000 | | | | 8/4/2024 |
| 21 | Motokorrese | 214 | cope | 1 | 270000 | 270000 | | | | 24/04/2024 |
| 22 | Pantallona pune | 327 | Cope | 22 | 2000 | | 44000 | | | 6/11/2024 |
| | **Totali** | | | | | **783800** | **147400** | | **0** | |

***Pergjegjesi Materialeve***

Muharrem Dosti

***Komisioni I inventarizimit***

1) Muharrem Dosti (Kryetar)
2) Erki Koka (Anetar)
3) Armand Sejdini (Anetar)
4) Holta Duli (Anetar)
5) Vjollca Hodo (Anetar)

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
## BASHKIA ELBASAN
### AGJENCIA E MBIKËQYRJES DHE KONTROLLIT
### DREJTORIA E TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE DHE TREGJEVE

**Nr.** 2863 **prot.** **Elbasan, më** 22.05**.2026**

## RELACION

**"Mbi rivlerësimin e tarifës për zënien e hapësirës publike në zbatim të Rregullores së re për shfrytëzimin e hapësirës publike"**

## KËSHILLIT BASHKIAK, ELBASAN

Në mbështetje e në zbatim të:

- Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 140, datë 27.11.2025 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2026";
- Vendimit nr. 224, datë 01.04.2026 "Për miratimin e rregullores së shftytëzimit të hapësirës publike",

Paraqitet për shqyrtim dhe miratim propozimi për rivlerësimin e ***tarifës për zënien e hapësirës publike për vitin 2026,*** sipas Rregullores së shftytëzimit të hapësirës publike.

Përgjatë vitit 2025, në nivel kombëtar u ndërmor një aksion për lirimin e hapësirave publike të zëna në kundërshtim me ligjin, si pasojë e të cilit u hoqën strukturat dhe elementët e vendosur në këto hapësira dhe situata në terren pësoi ndryshime.

Si rrjedhojë e këyre ndryshimeve dhe me qëllim lehtësimin e subjekteve dhe mos penalizimin e tyre, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 27, datë 02.03.2026, afati për pagesën e tarifës së zënies së hapësirave publike u vendos data 31.07.2026.

Me hyrjen në fuqi të vendimit nr. 224, datë 01.04.2026 "Për miratimin e rregullores së shftytëzimit të hapësirës publike", u përcaktuan kritere dhe kushte të reja mbi mënyrën e shfrytëzimit të hapësirave publike në të gjithë territorin e RSH, duke sjellë nevojën për rivlerësimin e tarifës së zënies së hapësirës publike në përputhje me situatën aktuale dhe përcaktimet e reja.

➤ **PROPOZIMI:**

Propozohet që:

1. Për periudhën **Janar-Qershor 2026**, tarifa e shfrytëzimit të hapësirës publike të llogaritet mbi bazën e sipërfaqes faktike të përdorur nga subjektet përpara hyrjes në fuqi të rregullores së re. Afati i pagesës për këtë periudhë do të jetë data **31.07.2026.**

*Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

2. Për periudhën **Korrik-Shtator 2026**, vlerësimi i tarifës të kryhet në përputhje me përcaktimet dhe kriteret sipas Rregullores së re të shfrytëzimit të hapësirës publike. Afati i pagesës për këtë periudhë propozohet të jetë data **30.09.2026.**

3. Për periudhën **Tetor-Dhjetor 2026**, vlerësimi i tarifës të kryhet në përputhje me përcaktimet dhe kriteret sipas Rregullores së re të shfrytëzimit të hapësirës publike. Afati i pagesës për këtë periudhë propozohet të jetë data **31.12.2026.**

Ky ndryshim synon sigurimin e një administrimi sa më të saktë dhe të rregullt të hapësirave publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Elbasan, në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren e re të shfrytëzimit të hapësirës publike, si dhe tarifimin në mënyrë të drejtë të subjekteve.

Për sa më sipër, kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i rivlerësimit të tarifës së shfrytëzimit të hapësirës publike për vitin 2026, si dhe i afateve përkatëse të pagesës, sipas përcaktimeve të propozuara më sipër.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

*Konceptoi:*
*Juriste* *E. Illiu*
*Prgj. Sektori Vlerësimit* *Xh. Ajazi*
*Drejtori i D.T.T.V.T.* *K. Çullhaj*

**KRYETARI**
**Gledian Llatja**

**ME URDHËR E POROSI**
**ZV/KRYETAR**
**Asim Sula**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. _______ Prot.** **Elbasan, më ___.___.2026**

**PROJEKTVENDIM**

**Nr. ______ datë ___.___.2026**
**"Mbi rivlerësimin e tarifës për zënien e hapësirës publike në zbatim të Rregullores së re për shfrytëzimin e hapësirës publike"**

**KËSHILLIT BASHKIAK, ELBASAN**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administrata dhe Kryetari i Bashkisë *"Mbi rivlerësimin e tarifës për zënien e hapësirës publike në zbatim të Rregullores së re për shfrytëzimin e hapësirës publike"* bazuar në:

- ✓ Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
- ✓ Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 140, datë 27.11.2025 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2026";
- ✓ Vendimit nr. 224, datë 01.04.2026 "Për miratimin e rregullores së shftytëzimit të hapësirës publike",

**VENDOSI:**

Në kuadër të ndryshimeve të krijuara gjatë vitit 2025 në lidhje me përdorimin e hapësirave publike, si dhe me hyrjen në fuqi të Rregullores së re për Shfrytëzimin e Hapësirave Publike, paraqitet e nevojshme rivlerësimi i tarifimit për subjektet që ushtrojnë aktivitet në hapësira publike në territorin e Bashkisë Elbasan, në përputhje me kriteret, kushtet dhe rregullat e përcaktuara në Rregulloren e re. Për këtë arsye,

1. Për periudhën **Janar-Qershor 2026**, tarifa e shfrytëzimit të hapësirës publike të llogaritet mbi bazën e sipërfaqes faktike të përdorur nga subjektet përpara hyrjes në fuqi të rregullores së re. Afati i pagesës për këtë periudhë do të jetë data **31.07.2026.**
2. Për periudhën **Korrik-Shtator 2026**, vlerësimi i tarifës të kryhet në përputhje me përcaktimet dhe kriteret sipas Rregullores së re të shfrytëzimit të hapësirës publike. Afati i pagesës për këtë periudhë propozohet të jetë data **30.09.2026.**
3. Për periudhën **Tetor-Dhjetor 2026**, vlerësimi i tarifës të kryhet në përputhje me përcaktimet dhe kriteret sipas Rregullores së re të shfrytëzimit të hapësirës publike. Afati i pagesës për këtë periudhë propozohet të jetë data **31.12.2026.**

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Konceptoi:**
Juriste: E. Illiu
Përgj. Sek. Vlerësimit: Xh. Ajazi
Drejtori i DTTVT: K. Çullhaj
Drejtoria Juridike: A. Hoxha

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**
**Elsid Zyma**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE

Nr. 2944 Prot. Elbasan, më: 21 .5 .2026

# RELACION

*"Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent që do të përdoret si strehëz për qentë endacakë".*

*KËSHILLIT BASHKIAK*

*K Ë T U*

*Të nderuar Këshilltarë,*

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar; ligjin nr. 10465 datë 29.09.2011 *"Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane i relaton Këshillit Bashkiak si më poshtë:

Bashkia Elbasan ka kontrate qiramarrje me Z. Besnik Nasufi për pasurinë nr. 17/319- ND (8522-372 dt. 27.08.2021) me sipërfaqe 176 $m^2$, ndodhur në Z.K. 8522, Lagja "Çlirimi", për t'a përdorur si strehëz për qentë endacakë, e cila përfundon me datë 30.04.2027.
Qiradhënësi ka paraqitur kërkesën me Nr. 254 prot, datë 13.05.2026 *"Kërkesë për rinovim kontrate"*, pranë Bashkisë Elbasan për rinovimin e kontratës sipas dokumentacionit bashkëlidhur.
Për sa më sipër, dhe në zbatim të pikës V (Kohëzgjatja e kontratës) të kontratës që përfundoi, Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane i relaton Këshillit Bashkiak të miratojë marrjen me qira (rinovim kontrate) për ambjentin që do të përdoret si strehëz për qentë endacakë për periudhën (një) vjeçare nga data 01.05.2026 deri 30.04.2027, me vlerë qiramarrje prej 50,000 lekë/muaj përfshirë T.V.SH, me të njëjtat kushte të kontratës si në vitin e kaluar.
**Grumbullimi i qenve endacakë dhe ndjekja e proçedurave për kurim, sterilizim e disinfektim.**

**KRYETARI**
**Gledian Llatja**

**Me urdhër e porosi**
**ZV/KRYETAR**
**Asim Sula**

*Konceptoi: P.Sekt K.Shqau*
*Dr Drejtorie G.Keci*
*Dr i ASHPU E.Palloshi*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

**Nr. _____ Prot.** **Elbasan, më:___.___.2026**

# PROJEKT – VENDIM

**Nr.______Datë:____.___.2026**

***"Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent që do të përdoret si strehëz për qentë endacakë".***

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* i ndryshuar, ligjin nr. 10465 datë 29.09.2011 *"Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës___.__.2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Agjencia Shërbimeve Publike Urbane i relaton Këshillit Bashkiak, *"Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent që do të përdoret si strehëz për qentë endacakë";*

**V E N D O S I :**

1. Miratimin marrje me qira ambjentin me sipërfaqe 176 m$^2$, ndodhur në Z.K. 8522, Lagja *"Çlirimi"*, për periudhën 1 (një) vjeçare nga 01.05.2026 deri 30.04.2027, me vlerë qiramarrje prej 50,000 lekë/muaj përfshirë T.V.SH, për t'a përdorur si strehëz për qentë endacakë.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**
**Elsid Zyma**

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

*Konceptoi: K.Shqau*
*G.Keci*
*E.Palloshi*

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

373 / 25.X.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr 1378 Prot. Elbasan më: 16.06.2025.

# *KONTRATË QIRAJE*

Lidhur sot më datë 30. 06.2025, midis palëve kontraktuese si më poshtë vijon:

**Me cilësinë e** ***"Qiradhënësit"*****: Z. Besnik Nasufi**, datëlindja 16.02.1965, banues në Elbasan.

**Me cilësinë e** ***"Qiramarrësit"***: Bashkia Elbasan përfaqësuar nga kryetari **Z. Gledian Llatja.**

## *I-OBJEKTI I KONTRATËS*

Kjo kontratë ka si objekt marrjen me qira nga Bashkia Elbasan të pasurisë nr. 17/319- ND (8522-372 dt. 27.08.2021) me siperfaqe 176 $m^2$, ndodhur në Z.K. 8522, Lagja "Çlirimi", me tarifë mujore qiraje 50,000 lekë/muaj, *"Qiradhënësit"* Z. Besnik Nasufi për t'a përdorur si strehëz për qentë endacakë.

## *II-BAZA LIGJORE*

1. Ligji Nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, i ndryshuar;
2. Ligjit Nr. 7850 datë 29.07.1994 *"Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar;
3. Ligji Nr. 10465 datë 29.09.2011 *"Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar;
4. Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 43 , datë 30.05.2025 *"Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent që do të përdoret si strehëz për qentë endacake"*.

## *III-TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT*

1. ***"Qiradhënësi"*** është i detyruar t'i sigurojë në mënyrë të vazhdueshme energji elektrike dhe ujë të pijshëm ***"Qiramarrësit"***.
2. ***"Qiradhënësi"*** është i detyruar t'i sigurojë kushte të përshtatshme për grumbullimin, kurimin, sterilizimin dhe disinfektimin e qenëve endacakë ***"Qiramarrësit"***.
3. ***"Qiradhënësi"*** është i detyruar t'i sigurojë ujë 24 orë dhe aspiratorë për qarkullimin e ajërit ***"Qiramarrësit"***.
4. ***"Qiradhënësi"*** duhet të dorëzojë pronën objekt të kësaj kontrate qiramarrësit, me nënshkrimin e saj nga palët, me gjendje të lirë dhe të garantojë gëzimin e qetë të saj gjatë kohëzgjatjes së qirasë.
5. Janë në ngarkim të ***"Qiradhënësit"*** të gjitha detyrimet e taksave dhe tatimeve që rëndojnë mbi këtë pronë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve gjatë regjimit të kontratës së qirasë, do të zgjidhen me mirëkuptim midis tyre, në të kundërt për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata kompetente. Për sa është parashikuar në këtë kontratë vlejnë dispozitat përkatëse të kodit civil.

Kjo kontratë hartohet në 6 (gjashtë) kopje origjinale ku katër kopje i mban ***"Qiramarrësi"*** (Arkivë, Dr. Buxhet-Financë, Drejtoria Aseteve dhe Strehimit, Këshilli Bashkiak, Agjencia e Shërbimeve Publike), një kopje e merr ***"Qiradhënësi"***.

***"Qiradhënësi"***

**Besnik Nasufi**

***"Qiramarrësi"***

**KRYETARI**
**Gledian LLATJA**
**Me urdhër e porosi**
**ZV/KRYETAR**
**Asim Sula**

2515/2
12.06.2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI JURIDIK**

Nr. 6 0 7/1 Prot. Elbasan më 12.6. 2025

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.49 datë 30.05.2025 "Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent që do të përdoret si strehëz për qentë endacakë", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

Efektet juridike dhe financiare të kontratës të fillojnë në datën e miratimit të vendimit nr.49 datë 30.05.2025.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

254
13.05.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

# KARTELA SHOQËRUESE PRAKTIKE

Dërgues Besnik Wasufi Nr. Prot.______ Datë ___/___/___

Shkurtimi i lëndës ainotim Tokave

| | |
|---|---|
| Për trajtim nga | G. Dyrmyshi |
| (Struktura të tjera të ngarkuara) | ASHPU |
| Me porosi | 08.05.26 |

Afati ☐ Normal (7 ditë) ☐ Prioritet (3 ditë) ☐ Urgjent (brenda ditës) ☐ Pa afat/Për dijeni/Tjetër

Data 23 /04 /26 Nr. Prot. 1023 Nënshkrimi (________)

Marrë në dorëzim ________ Nënshkrimi (________)

Kalim për trajtim (struktura) ________ ___/___/___

Me porosinë Nuk është kompetencë e Dr. P.P.S. 07.05.2026

Marrë në dorëzim ________ Nënshkrimi (________)

Kalim për trajtim Specialisti Z. Jorelo Tufuloba ___/___/___

Me porosinë ________

Trajtim i materialit përfunduar më ___/___/___ Specialisti ________

Trajtim i materialit përfunduar më ___/___/___ Përgjegjës sektori ________

Trajtim i materialit përfunduar më ___/___/___ Sekretari i përgjithshëm ________

3 prot.

/2026

san

# KERKESE

## BASHKISE ELBASAN

uari/a Besnik Hasufi banues/e ne adrese Cerrmi

Cel 0692260101 dhe dokument identifikimi nr

Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin 119/2014 date 18.09.2014 " Per te drejten e informimit "

Kopjen kontrate per ambjentin

punetoret si ndihmes per qendren ende

te

ime e bazoj ne arsyetimin se :

*ur do te gjeni dokumentat e poshteshenuara :*

Besnik Hasufi

Elbasan me date 09/4/2026

..............................................................................................................................................

2515/2
12.06.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr 1047 Prot. Elbasan më 12.06.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.49 datë 30.05.2025 "Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent që do të përdoret si strehëz për qentë endacakë", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

Efektet juridike dhe financiare të kontratës të fillojnë në datën e miratimit të vendimit nr.49 datë 30.05.2025.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, www.prefekti.elbasan.gov.al , email: prefekti.elbasan@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1535/ Prot. Elbasan, më: 02.06.2025

# V E N D I M

Nr. 49 Datë: 30.05.2025

*"Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent që do të përdoret si strehëz për qentë endacakë".*

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, ligjin nr. 10465 datë 29.09.2011 *"Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30.05.2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane i relaton Këshillit Bashkiak, *"Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent që do të përdoret si strehëz për qentë endacakë"*;

## V E N D O S I :

1. Miratimin marrje me qira ambjentin me sipërfaqe 176 m$^2$, ndodhur në Z.K. 8522, Lagja *"Çlirimi"*, për periudhën 1 (një) vjeçare nga 01.05.2025 deri 30.04.2026, me vlerë qiramarrje prej 50,000 lekë/muaj përfshirë T.V.SH, për t'a përdorur si strehëz për qentë endacakë.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Lutfi Lala

SEKRETARI
Sokol Sinani

*Konc P.sektori K.Shqda*
*Dr.Drejtorie Sh.Arapi*
*Pranoi Dr Aslipu A.Lula*

## IV-TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

1. *"Qiramarrësi"* është i detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga harxhimi i energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm *"Qiradhënësit"*.
2. *"Qiramarrësit"* nuk i lejohet të përdorë ambjentin e marrë me qira jashtë destinacionit të përshkruar në kontratë.
3. *"Qiramarrësit"* nuk i lejohet që pronën e dhënë me qira t'a japë me nënqira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.
4. *"Qiramarrësit"* nuk i lejohet të bëjë asnjë adoptim të ambjenteve të marrë me qira që do të konsistonte në ndërhyrje të strukturave ndërtimore pa marrë miratimin nga ana *"Qiradhënësit"*.

## V-KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kjo kontratë përfundon më 30.04.2026.
Palët mund të merren vesh për zgjatjen e afatit të kontratës duke lajmëruar me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të saj.

## VI- MËNYRA E PAGESËS

*"Qiramarrësi"* i paguan *"Qiradhënësit"* tarifën e qirasë prej 50,000 lekë në muaj brenda datës 28 të çdo muaji.

Pagesa do të bëhet në llogarinë bankare me nr. 405009842CLIDCLALLA1 dhe IBAN AL77205310500009842CLIDCLALLA pranë Bankës Kombëtare Tregtare, në emër të Z. Besnik Nasufi.

## VII-TË PËRGJITHSHME

Kjo kontratë mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga palët para afatit, kur krijohen kushte të tilla që e bëjnë të pamundur vazhdimin e saj, konkretisht:

1. Kur *"Qiramarrësi"* nuk paguan detyrimet mujore për më shumë se dy muaj nga afati i përcaktuar në kontratë.
2. Nëse si pasojë e ndonjë akti ligjor, nënligjor, apo akt tjetër administrativ të organeve kopetente *"Qiramarrësi"* do të ishte i detyruar të zgjidhë kontratën, duke njoftuar me shkrim *"Qiradhënësit"* 30 ditë përpara. Gjatë afatit të njoftimit *"Qiradhënësi"* do të përfitojë qiranë mujore të parashikuar.
3. *"Qiradhënësi"* nuk plotëson apo respekton kushtet e parashikuara në kontratë.
4. Në momentin e dorëzimit hartohet një *proces-verbal* i dorëzimi të objektit të dhënë me qira.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**

Nr.2969 Prot. Elbasan, më 22/05/2026

**RELACION**

**"PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT PËR PROJEKTIN "SOILSTICE – FUQIZIMI I INSTITUCIONEVE DHE NJËSIVE TONA VENDORE PËR TRANSFORMIMIN E TOKËS, PËRFSHIRJEN DHE ANGAZHIMIN QYTETAR"**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**Elbasan**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT (GRANT AGREEMENT) PËR PROJEKTIN "SOILSTICE"**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Programit të Bashkimit Europian Horizon Europe, si dhe Marrëveshjes së Financimit (Grant Agreement) për projektin ndërkombëtar "SOILSTICE – Strengthening Our Institutions and Localities for Soil Transformation, Inclusion, and Civic Engagement" ("Fuqizimi i institucioneve dhe njësive vendore për transformimin e tokës, përfshirjen dhe angazhimin qytetar"), i financuar nga Bashkimi Europian në kuadër të programit Horizon Europe dhe i zbatuar nga një konsorcium partnerësh ndërkombëtarë;
Projekti SOILSTICE përfaqëson një iniciativë europiane në kuadër të Mission Soil 2025 CSA (HORIZON-MISS-2025-05-SOIL-09), e orientuar drejt mbrojtjes dhe restaurimit të shëndetit të tokës përmes qeverisjes pjesëmarrëse, forcimit të kapaciteteve institucionale dhe promovimit të angazhimit qytetar.

Projekti adreson sfidat që lidhen me degradimin e tokës, erozionin, humbjen e biodiversitetit dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike, duke promovuar politika dhe zgjidhje të qëndrueshme për menaxhimin territorial, në përputhje me prioritetet dhe objektivat strategjike të Bashkimit Europian në fushën e klimës, mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
Gjithashtu, paraqitet për miratim **Marrëveshja e Financimit (Grant Agreement)**, e lidhur ndërmjet: Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Kërkim (REA), dhe konsorciumit të përfituesve, ku Bashkia Elbasan merr pjesë si partnere zbatuese.
Kjo marrëveshje përbën kontratën bazë ligjore që përcakton aktivitetet, buxhetin, kohëzgjatjen, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve për zbatimin e projektit.

Objektivat e projektit janë:

- Angazhimi i qytetarëve dhe aktorëve lokalë në qendër të procesit, përmes bashkëhartimit gjithëpërfshirës të TMA-ve[1].
- Ndërtimi i kapaciteteve përmes trajnimeve të përshtatura, shkëmbimit të eksperiencave dhe paketave praktike për bashkitë dhe komunitetet.
- Rritja e ndërgjegjësimit përmes komunikimit kreativ, storytelling-ut dhe dialogut politik të lidhur me Direktivën për Monitorimin dhe Rezistencën e Tokës.
- Shkëmbim i njohurive open-source përmes TMA Studio dhe Community of Practice për të garantuar vazhdimësinë, shkallëzimin dhe replikimin e modelit.

Projekti synon: përmirësimin e menaxhimit të tokës, rritjen e ndërgjegjësimit qytetar dhe pjesëmarrjes komunitare, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendore dhe aktorëve lokalë, zhvillimin e mekanizmave të qëndrueshëm për menaxhimin territorial.
Projekti mbështetet në direktivat e propozuara për Monitorimin dhe Rezistencën e Tokës, të lançuara nga Komisioni Evropian, European Green Deal, Strategjia e Biodiversitetit dhe Planet Strategjike të Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP), dhe në *Planin lokal për përshtatje ndaj ndryshimeve të klimatike (*LAP) i miratuar edhe në Këshillin Bashkiak dhe konfirmuar nga prefekti.

Nëpërmjet këtij projekti synohet kontributi në objektivat e Bashkimit Evropian për klimën, biodiversitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm me kohështrirje 38 muaj, me periudhë zbatimi: **1 Shtator 2026 – 31 Tetor 2029**, buxheti total: **5,000,000 Euro** e cila financohet **100% grant nga Bashkimi Evropian.** Bashkia Elbasan do të përfitojë 60.000 € nga projekti i cili do të konsistojë në paga si: kostot e personelit/ A1 – Punonjës (Employees), A2 – Persona fizikë me kontratë direkte dhe funksione të deleguara me vlerë totale 42,000 €; për udhëtime (travel), totali: 4,000 €; për mallra, punë dhe shërbime të tjera totali: 2,000 € dhe për kosto indirekte (Flat rate)[2] totali: 12,000 €.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Bashkia Elbasan angazhohet që:

- të zbatojë aktivitetet sipas përshkrimit teknik të projektit,
- të menaxhojë fondet në përputhje me rregullat financiare të Bashkimit Evropian,
- të raportojë periodikisht në aspektin teknik dhe financiar,
- të respektojë parimet e transparencës, etikës dhe shmangies së konfliktit të interesit,
- të ruajë dokumentacionin dhe të pranojë procedurat e kontrollit dhe auditimit.

**Në zbatim të projektit me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Elbasan do të ngrihet grup pune për ndjekjen e zbatimit, koordinimin me partnerët dhe menaxhimin administrativ e financiar.**
Pjesëmarrja në këtë projekt: siguron akses në fonde të Bashkimit Evropian pa barrë financiare për buxhetin vendor, kontribuon në rritjen e kapaciteteve institucionale, forcon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe përfshirjen në rrjete evropiane, mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Në këtë kuadër, miratimi i marrëveshjes është i domosdoshëm për institucionalizimin dhe zbatimin e projektit në nivel vendor.

---

[1] Marrëveshjeve Territoriale të Menaxhimit
[2] shpenzime administrative; komunikim dhe koordinim; përdorimi i zyrës; (internet, energji, ujë); materiale të vogla konsumi; menaxhim projekti; overheads/indirect costs; organizim rutinë takimesh; transport lokal; shpenzime bankare; telefon/internet; kostot operative të stafit mbështetës.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e projektit dhe përfitimet për zhvillimin lokal, propozohet miratimi i Marrëveshjes së Financimit (Grant Agreement) për projektin "SOILSTICE", së bashku me dokumentacionin përkatës të tij.

Dhënia e dakordësisë nga ana juaj do të mundësojë vijimin e zbatimit të projektit, përmes angazhimit të strukturave përgjegjëse.

Ju faleminderit!

| | | |
|---|---|---|
| **Konceptoi:** | **P.S.P.D** | **K. Kreka** |
| | **P. D. ZH.E.K.T** | **Z.Shpata** |
| **Pranoi:** | **D.D.I.E.P.D** | **E. Çuni** |
| | **D.D.F.B** | **A.Merkja** |
| | **D.D.J.I** | **A.Hoxha** |
| **Miratoi:** | **D.P.D..ZH. E.K.T** | **A.Canaj** |

**KRYETARI**

**Gledian LLATJA**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**Nr.2872 Prot** **Elbasan më 22.05.2026**

# Relacion

**" Mbi miratimin e strukturës së Çerdhes publike nr.5"**

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**BASHKIA ELBASAN**

***Të nderuar Këshilltarë,***

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 155, datë 24.12.2025 "Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Elbasan dhe njësive operative, tabelat e pagave, nivelet e pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë dhe të punonjësve të Bashkisë dhe njësive operative vartëse të saj për vitin 2026", Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, pranë Bashkisë Elbasan, kërkon miratimin e strukturës së re të Çerdhes Publike Nr. 5, me përbërjen si më poshtë:

1. Përgjegjëse Çerdhe 1
2. Kujdestare 9
3. Logopede 1
4. Kuzhiniere 1
5. Ndihmës Kuzhiniere 1
6. Sanitare 2

Kjo strukturë propozohet me qëllim garantimin e funksionimit normal të institucionit, përmirësimin e shërbimit ndaj fëmijëve dhe përmbushjen e nevojave organizative të çerdhes.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin tuaj, mirëpresim miratimin nga ana juaj.

Konc.: Specialist Protokoll-Arkive M. Haxhiymeri
Pranoi: Drejtor I Drejtoris Sherbimeve Y.Kasa
Miratoi: Drejtore e DPAP D.ÇELA

**ME URDHER POROSI** **KRYETAR**

**ZV/KRYETARE** **Gledian LLATJA**
**Klaudia KRASNIKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Nr_____Prot Elbasan më , ____.___2026

PROJEKTVENDIMI

Nr___ date ____.____2026

**" Mbi miratimin e strukturës së Çerdhes publike nr.5"**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 155, datë 24.12.2025 "Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Elbasan dhe njësive operative, tabelat e pagave, nivelet e pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë dhe të punonjësve të Bashkisë dhe njësive operative vartëse të saj për vitin 2026",

## VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës së Çerdhes Publike Nr. 5, sipas përbërjes së propozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Konc.: Specialist Protokoll-Arkive M. Haxhiymeri
Pranoi: Drejtor I Drejtoris Sherbimeve Y.Kasa
Miratoi : Drejtore e DPAP D. Çela
Drejtoria Juridike A. Hoxha

**ME URDHER POROSI**

**ZV/KRYETARE**
**Klaudia KRASNIKA**

**KRYETAR**

**Gledian LLATJA**

Adresa: Bashkia Elbasan,Rr."Q.Stafa", Tel + 355 54 400152,e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web.www.elbasani.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE, MJEDISIT, BUJQËSISË, PYJEVE DHE KULLOTAVE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr.2925 Prot. Elbasan më, 21.05.2026

# RELACION

**Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Gramos Thanas Nasko banues në lagjen "Dyli Haxhire", nr. 3 dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan**

*Të nderuar anëtarë të Komisionit të Mbrojtjes Civile,*

Në zbatim të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile" dhe të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", sektori përkatës, pas marrjes së kërkesës nga **Z. Gramos Thanas Nasko** ka kryer konstatimin e banesës. Pas ardhjes së kërkesës në Drejtorinë e Mbrojtjes Civile me nr.1025 prot. datë 29.4.2026, grupi i konstatimit për djegien e banesës në lagjen "Dyli Haxhire", nr. 3 në datën 27.4.2026 (konfirmuar edhe nga Vërtetimi i SHMZSH nr. 04 datë 29.04.2026) ka hartuar proçes-verbalin përkatës të datës 29.04.2026. Pas plotësimit të dokumentacionit, është vijuar me përcjelljen e dokumentacionit komisionit të vlerësimit të dëmeve ngritur në Bashkinë Elbasan me Urdhër nr. 64 date 22.01.2025 "Per ngritjen e komisionit per vleresimin e demeve te shkaktuara ne objekte banimi nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi te tjera" për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga ekspertët e këtij komisioni. Ky komision, ka përgatitur preventivin mbi vlerën e dëmeve të objektit nga ana ndërtimore (sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga sistemi E-albania) duke përfshirë në të edhe vlerën e pajisjeve dhe orendive të dëmtuara (mbështetur në çmimet mesatare aktuale të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ardhur me shkresë nr. 6024/1 prot. datë 22.4.2025) nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve ndërtimore të banesës së Z. Gramos Thanas Nasko, është në masën **357,078** (treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e tetë) lekë.
- Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi në banesës është në masën **327,633** (treqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre) lekë.

Në bazë të VKM-së cituar më sipër nr. 329 datë 16.05.2012 vlera e dëmeve ndërtimore në banesën e djegur, e përcaktuar nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë

merret nga pronari në masën prej 50% të shumës së nxjerrë.

Pra në këtë rast **357,078 x 50% = 178,539 lekë.**

Kësaj shume i shtojmë vlerën prej **327,633** (treqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre) lekë që është vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi.

Në përfundim nga komisioni i vlerësimit të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së **Z. Gramos Thanas Nasko** i takojnë **178,539 + 327,633 = 506,172** (pesëqind e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

***Duke Ju falenderuar,***

| | | |
|---|---|---|
| Konceptoi: | Specialist | I. Hoxholli |
| Miratoi: | Drejtori MC | N. Sinani |
| Konfirmoi: | Dr. PPMCMBPK | Sh. Çullhaj |

**KRYETARI**
**Gledian Llatja**

**Me Urdhër e Porosi**
**ZV/KRYETARI**
**Asim Sula**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK
*Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Nr. ______ Prot. Elbasan më, ___.____.2026

**PROJEKT VENDIM**

**Nr._______Datë_____.___.2026**

**Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Gramos Thanas Nasko banues në lagjen "Dyli Haxhire", nr. 3 dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan**

